PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU – KOSTT SH.A

31 DHJETOR 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	1
Pasqyra e pozicionit financiar	5
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	6
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	7
Pasqyra e rrjedhës së parasë	8
Shënimet për pasqyrat financiare	9

RSM KOSOVO SH.P.K

Rr. Xhevdet Doda
Dukagjini Residence, Hyrja
B-C, Kati 2, nr. B56
10 000 Prishtina
Republic of Kosovo

DL +383 45 666 888

www.rsmglobal.com\kosovo

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për aksionarin dhe Menaxhmentin e Kostt SH.A

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të KOSTT Sh.A. ("Kompania"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2022 dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së të parasë për vitin e përfunduar me këtë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë më 31 Dhjetor 2022, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhat se saj të parasë për vitin e përfunduar në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar(SNRF).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare' në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionistë të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi BSNEK), dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Kosovës, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë.

Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykimit tonë profesional, kishin më shumë rëndësi në auditimin tonë të pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje janë adresuan në kontekstin e auditimit tonë të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në formimin e opinionit tonë mbi to dhe ne nuk shprehim një opinion të veçantë për këto çështje. Çdo çështje e auditimit dhe pergjigja jonë parketëse përshkruhen më poshtë.

RSM Kosovo Sh.p.k is a member of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.

Çështjet kryesore të auditimit	Si është adresuar çështja në auditimin tonë
Jetëgjatësia e zhvlerësueshme e pronave, impianteve dhe pajisjeve Prona, impiantet dhe pajisjet më 31 dhjetor 2022 kishin një vlerë neto kontabël prej 132,900 mijë euro që është 45 % e totalit të aseteve. Zhvlerësimi i akumuluar arriti në 155,844 mijë euro. Ne identifikuam jetëgjatësinë e zhvlerësueshme të pronave, impianteve dhe pajisjeve si çështje kryesore të auditimit sepse kërkon që menaxhmenti të ushtrojë gjykim të rëndësishëm në lidhje me vlerësimin e jetës së dobishme dhe shumën e zhvlerësueshme të pasurive duke marrë parasysh natyrën, kohën dhe gjasat e ndryshimeve në faktorët teknikë të cilët mund të ndikojnë në jetëgjatësinë e dobishme të pasurive dhe për këtë arsye mund të kenë një ndikim material në shpenzimet e zhvlerësimit për vitin. Ne i referohemi shënimit të pasqyrave financiare 2.8, 3 dhe 4 Prona, Impiante dhe Pajisje.	Auditmi i pronave, impianteve dhe pajisjeve është një kombinim i kontrolleve dhe procedurave thelbësore të auditimit. Përgjigja jonë e auditimit përfshinte si vijon: • Të kuptuarit mbi gjykimin e menaxhmentit në lidhje me vlerësimin e jetës së dobishme të pronës, impianteve dhe pajisjeve dhe testimi i kontrolleve kyqe. • Mbi një bazë të mostrës ne kemi zgjedhur dhe krahasuar jetën e dobishme të pasurisë në vitin aktual me vitin paraprak për të përcaktuar nëse kishte ndonjë ndryshim të rëndësishëm në jetën e dobishme të pasurive dhe kemi konsideruar arsyeshmërinë e ndryshimeve bazuar në njohuritë tona për biznesin dhe industrinë. • Lidhur me shtesat, ne kemi testuar nëse shtesat janë klasifikuar në kategorinë e saktë të pronave, impianteve dhe pajisjeve, zhvlerësimi filloi kur pasuritë janë në dispozicion për përdorim dhe nëse jeta e dobishme dhe vlerësimet e vlerës së mbetur nga kompania janë të arsyeshme dhe të shpalosura në shënimet për pasqyrat financiare. • Sfidimi i supozimeve dhe gjykimeve kritike të përdorura nga menaxhmenti duke krahasuar vlerësimet dhe planet e kaluara të menaxhmentit me vlerësimet dhe planet e vitit aktual duke marrë parasysh zhvillimin në sektorin e energjisë në vend. • Vlerësimi i mjaftueshmërisë së shpalosjeve te ndërmarrjes në lidhje me pronen, impiantet dhe paisjet.
Çështjet kryesore të auditimit	**Si është adresuar çështja në auditimin tonë**
Vlera bartëse e të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera Të arkëtueshmet tregtare njihen me vlerën e tyre të parashikuar të realizueshme, e cila është shuma origjinale e faturuar minus provizioni i vlerësuar i zhvlerësimit. Ekzistenca dhe vlerësimi i të arkëtueshmeve tregtare është një çështje kyçe e auditimit në auditim për shkak të madhësisë së bilancit të arkëtueshmeve tregtare dhe nivelit të lartë të gjykimit të menaxhimit të përdorur në përcaktimin e provizioneve të lejimit të zhvlerësimit. Ne i referohemi shënimit 2.14, 2.15, 3, 9 të pasqyrave financiare Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera dhe shënimit 28a.	Procedurat tona të auditimit përfshinë si vijon: • Ne kemi vlerësuar procedurat e kontrollit kreditor të Kompanisë dhe vlerësuam dhe vërtetuam vjetërsinë e llogarive të arkëtueshmeve tregtare dhe tjera. • Ne vlerësuam rikuperueshmërinë në bazë të një mostre duke iu referuar inkasimeve te parave pas përfundimit të vitit, marrëveshjes për kushtet e kontratës në fuqi; • Ne kemi marrë në bazë të mostrës konfirmimet nga klientet dhe kemi rakorduar diferencat. • Ne kemi shqyrtuar përshtatshmërinë e gjykimeve në lidhje me provizionet për zhvlerësim për të arkëtueshmet tregtare dhe kemi vlerësuar përshtatshmërinë e tyre. • Ne kemi konsideruar plotësinë dhe saktësinë e informacioneve shpjeguese.

Informacione të tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informacione të tjera. Informacioni tjetër përfshin raportin e menaxhimit dhe pasqyrën e qeverisjes korporative, por nuk përfshin pasqyrat financiare dhe raportin tone të auditimit.

Opinioni ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informatat tjera dhe përveç se në masën e shprehur në mënyrë eksplicite në raportin tonë, ne nuk shprehim asnjë konkluzion mbi të .

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është ti lexojmë informatat tjera, dhe duke vepruar kështu, të konsiderojmë nëse informatat tjera janë materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose njohuritë tona të marra në auditim, ose në të kundërt duket se është materialisht i keqdeklaruar.

Në lidhje me raportin e menaxhimit dhe deklaratën e qeverisjes korporative ne kemi marr parasysh nëse përfshin shpalosjet e kërkuara nga neni 7 i Ligjit Nr. 06 / L-032 për kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin.

Bazuar, vetëm në punën e kërkuar të ndërmarrë gjatë auditimit të pasqyrave financiare dhe procedurave të mësipërme, sipas për opinionin tone :

- informacioni i shpalosur në raportin e menaxhmentit për vitin financiar për të cilin janë përgatitur pasqyrat financiare, është konsistent, në të gjitha aspektet materiale me informacionin në pasqyrat financiare dhe përgatitet në përputhje me kërkesat e nenit 7 të Ligjit nr. 06/ L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, dhe,

- deklarata e qeverisjes korporative është përgaditur në përputhje me nenin 7 të Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim dhe është konsistent me informacionin në pasqyrat financiare.

Për më tepër, bazuar në njohuritë dhe kuptimin e entitetit dhe mjedisit në të cilin operon, të marra gjatë auditimit, neve na kërkohet të raportojmë nëse kemi identifikuar ndonjë keqdeklarim material të fakteve në informata të tjera. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në këtë drejtim.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe të ngarkuarve me qeverisje për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Kompanisë për të vazhduar aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet në lidhje me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likuidojë Kompaninë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç se ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë .

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne :

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave individuale financiare, si pasojë e mashtrimeve ose gabimeve, planifikojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit për zbutjen e këtyre rreziqeve, si dhe marrim evidence të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos-zbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.

- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Menaxhmenti.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Kompanisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Kompanisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar për qeverisjen, përveçse çështjeve të tjera, edhe fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të konsiderueshme në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne gjithashtu iu deklarojmë personave të ngarkuar me qeverisjen se ne jemi në pajtueshmëri me kërkesat etike përkatëse lidhur me pavarësinë, dhe iu komunikojmë atyre të gjitha marrëdhëniet dhe çështjet e tjera arsyeshëm mund të mendohet se cenojnë pavarësinë tonë, dhe aty ku është e aplikueshme, marrim masat mbrojtëse përkatëse.

Nga çështjet e komunikuara personave të ngarkuarato me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që ishin kyqe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe për këtë arsye janë çështjet kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin e auditorëve tone, përveç rasteve kur ligji ose rregullorja e përjashton zbulimin publik për këtë çështje ose kur, në rrethana jashtëzakonisht të rralla, ne përcaktojmë se një çështje nuk duhet të komunikohet në raportin tonë, sepse pasojat e pafavorshme të një gjëje të tillë do të priten në mënyrë të arsyeshme. të tejkalojnë përfitimet e interesit publik nga një komunikim i tillë.

Raporti mbi kërkesat e tjera ligjore dhe rregullatore

Ne jemi përzgjedhur nga një proces i hapur tenderimi dhe u emëruam më 29 Shtator 2020 si auditorë të Kompanisë për një periudhë tre-vjeçare. Ky është viti i tretë i pandërprer si auditorë të Kompanisë.

Ne konfirmojmë se:

- Ne nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo-audituese të referuara në Nenin 5 (1) të udhëzimit administrativ nr. 02/2019 dhe se kemi mbetur të pavarur nga Kompania në kryerjen e auditimit.

RSM Kosovo Sh.p.k.

RSM Kosovo Sh.p.k

Prishtinë, Republika e Kosovës

19 Prill 2023

Valbona Hamiti

Auditore Ligjore

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
MË 31 DHJETOR 2022

	Shënimet	31 Dhjetor 2022 EUR'000	31 Dhjetor 2021 EUR
PASURITË			
PASURITË AFATGJATA			
Prona, impiantet dhe paisjet	4	132,900	145,194
Pasuritë e paprekshme	5	407	607
Investimet në shoqëri	6	617	868
Investimet financiare	7	40	40
GJITHSEJ PASURITË AFATGJATA		**133,964**	**146,709**
PASURITË AFATSHKURTËRA			
Stoqet	8	4,407	4,448
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	9	84,101	77,423
Tatimi i arkëtueshem mbi të ardhurat e korporatave		59	427
Depozitat me afat	10	4,800	17,064
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	11	67,273	35,450
GJITHSEJ PASURITË AFATSHKURTËRA		**160,640**	**134,812**
GJITHSEJ PASURITË		**294,604**	**281,521**
EKUITETI DHE DETYRIMET			
EKUITETI			
Kapitali aksionar	12	25	25
Rezerva e transferimit	13	53,376	53,367
Fitimet e mbajtura		47,234	46,440
GJITHSEJ EKUITETI		**100,635**	**99,832**
DETYRIMET			
DETYRIMET AFATGJATA			
Grantet e shtyra	14	43,034	49,583
Detyrimet e shtyera tatimore	25	6,539	6,068
Huatë	15	26,583	32,597
GJITHSEJ DETYRIMET AFATGJATA		**76,156**	**88,248**
DETYRIMET AFATSHKURTËRA			
Huatë	15	32,457	6,016
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	16	85,356	87,425
GJITHSEJ DETYRIMET AFATSHKURTËRA		**117,813**	**93,441**
GJITHSEJ DETYRIMET		**193,969**	**181,689**
GJITHSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET		**294,604**	**281,521**

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Bordi i Drejtorëve të Kompanisë në 17 Prill 2023 dhe janë nënshkruar në emër të saj nga :

Mr. Evetar Zeqiri
Kryeshefi Ekzekutiv

Mr. Nebih Haziri
Zyrtar Kryesor Financiar

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2022

	Shënimet	2022 EUR'000	2021 EUR'000
Shitjet	17	34,720	30,433
Të ardhurat e tjera operative	18	16,189	7,528
Të ardhura nga burimet e ripërtritshme të energjisë, neto	19	1,236	6,533
GJITHËSEJ TË ARDHURAT		**52,145**	**44,494**
Të ardhura të tjera nga grantet	20	64,049	14,392
Humbja e energjisë	21	(78,067)	(52,663)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4,5	(15,538)	(15,777)
Shpenzimet operative	22	(12,499)	(9,984)
Shpenzimet e personelit	23	(5,345)	(5,287)
Dëmtimi i të arkëtueshmeve	8	(3,012)	-
Riparimi dhe mirëmbajtja	24	(606)	(827)
FITIMI/(HUMBJA) NGA OPERACIONET		**1,127**	**(25,652)**
Të ardhurat financiare		1,845	924
Të ardhurat shpenzimet	25	(1,456)	(1,370)
Shpenzimet financiare /(Të ardhurat)		**389**	**(446)**
Pjesa e fitimit dhe humbjes në shoqëri	6	(251)	-
FITIMI/(HUMBJA) PARA TATIMIT		**1,265**	**(26,098)**
Shpenzimet e tatimit në fitim	26	(471)	(549)
FITIMI/(HUMBJA) PËR VITIN		**794**	**(26,647)**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
Të ardhurat nga ndryshimet në rezervat		9	-
Gjithsej të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		**9**	**-**
GJITHSEJ TË ARDHURAT /(HUMBJA) GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN		**803**	**(26,647)**

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2022

	Kapitali aksionar EUR '000	Rezervat e rivlerësimit EUR '000	Fitimet e mbajtura EUR '000	Gjithësej EUR '000
MË 01 JANAR 2022	**25**	**53,367**	**46,440**	**99,832**
Transaksioni me pronarin	-		-	
Gjithsej transaksionet me pronarin		-	-	-
Fitimi për vitin		-	794	**794**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:		9	-	**9**
GJITHSEJ TË ARDHURAT TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	-	**9**	794	**803**
MË 31 DHJETOR 2022	**25**	**53,376**	**47,234**	**100,635**
MË 01 JANAR 2021	**25**	**53,367**	**73,087**	**126,479**
Transaksioni me pronarin	-	-	-	-
Gjithsej transaksionet me pronarin	-	-	-	-
Humbja për vitin	-	-	(26,647)	(26,647)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:	-	-	-	-
GJITHSEJ TË ARDHURAT TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	-	-	**(26,647)**	**(26,647)**
MË 31 DHJETOR 2021	**25**	**53,367**	**46,440**	**99,832**

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2022

	Shënimet	2022 EUR'000	2021 EUR'000
AKTIVITETET OPERATIVE			
(Humbja)/Fitimi para tatimit		1,265	(26,098)
Rregulluar për:			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4,5	15,538	15,777
Të ardhurat nga interesi		(1,845)	(924)
Shpenzimet e interesit		1,913	1,370
Provizioni për detyrimet		251	452
Shlyerja e Pronës,Impianteve dhe Pajisjeve		22	3
Dëmtimi i të arkëtueshmeve		3,012	-
Pjesa e fitimit dhe humbjes në shoqëri		251	-
Të ardhurat e shtyra nga grantet		(64,049)	(14,392)
Të ardhurat(Humbja) operative para ndryshimeve në kapitalin qarkullues		**(43,641)**	**(23,812)**
Ndryshimet në kapitalin qarkullues:			
Stoqet		41	(67)
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera		(5,383)	(64,282)
Detyrimet tregtare dhe të tjera		(4,359)	74,880
Fitimi/(humbja) nga operacionet pas ndryshimeve në kapitalin qarkullues		**(53,342)**	**(13,281)**
Tatimi mbi fitimin (i paguar)		(59)	(975)
Paraja e (paguar)/gjeneruar nga aktivitetet operative		**(53,401)**	**(14,256)**
AKTIVITETET INVESTUESE			
Interesi i arkëtuar		279	997
(Rritja)/Rënia e investimeve në shoqëri		-	(566)
(Blerja) e pronës, pajisjeve dhe pasurive të paprekshme		(3,069)	(1,315)
(Rritja)/Rënia në depozitat me afat		12,000	30,000
Dividenda e pranuar nga investimet		-	23
Paraja e gjeneruar (përdorur) në aktivitete investuese		**9,210**	**29,139**
AKTIVITETET FINANCIARE			
Interesi (i paguar)/Arkëtuar		(1,913)	(1,370)
Huazimet (paguar)/Arkëtuar		20,427	(6,014)
Grantet e marra		57,500	
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet financiare		**76,014**	**(7,384)**
NDRYSHIIMI NETO NË PARA DHE EKUIVALENTËT E PARASË		**31,823**	**7,499**
Paraja dhe ekuivalentet e parasë në fillim		35,450	27,951
PARAJA DHE EKUIVALENTET E PARASË NË FUND	11	**67,273**	**35,450**

SHËNIMET

		Faqe
1	Informata të përgjithshme	10
2	Përmbledhje e politikave kontabël të rëndësishme	10
3	Gjykime të rëndësishme dhe burime kyçe të të pasigurisë në vlerësim	21
4	Prona, impiantet dhe pajisjet	22
5	Pasuritë e paprekshme	23
6	Investimet në shoqëri	23
7	Investimet financiare	24
8	Stoqet	25
9	Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	25
10	Depozitat me afat	26
11	Paraja dhe ekuivalentet e parasë	26
12	Kapitali aksionar	26
13	Rezerva e transferit	26
14	Grantet e Shtyra	27
15	Huatë	28
16	Detyrimet tregtare dhe të tjera	29
17	Të ardhurat	29
18	Të ardhurat e tjera operative	30
19	Të ardhurat/Shpenzimet nga burimet e ripërtëritshme të energjisë	30
20	Të ardhurat tjera nga Grantet	30
21	Humbja e Energjisë	30
22	Shpenzimet e tjera operative	30
23	Shpenzimet e personelit	31
24	Riparimet dhe Mirëmbajtjet	31
25	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	31
26	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	32
27	Instrumente Financiare sipas kategorive	33
28	Matja e vlerës së drejtë	34
29	Informacion mbi rreziqet financiare	35
30	Menaxhimi i riskut kapital	37
31	Palët e lidhura	38
32	Zotimet dhe kontingjencat	38
33	Ngjarjet pas datës raportuese	40

SHËNIME
PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2022

1 INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Operator Sistemit Transmisioni dhe Tregut (këtu e tutje "Kompania" ose "KOSTT Sh.A") u themelua si një entitet i pavarur më 23 dhjetor 2005 nga transformimi i Korporata Energjetike e Kosovës ("KEK") dhe u regjistrua si një kompani aksionare Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/6 e datës 8 Shkurt 2001 mbi Organizatat e Biznesit ("Rregullorja") me numrin e regjistrimit të biznesit 70325350. Kompania filloi punën e saj në mënyrë të pavarur nga 1 korriku 2006 sipas marrëveshjes midis KEK Sh.A. dhe KOSTT Sh.A. në lidhje me marrëdhënien kalimtare, tregtare dhe operacionale midis KEK SH.A dhe KOSTT SH.A mbi transferimin e përgjegjësisë për operacionet dhe mirëmbajtjen e Rrjetit të Transmetimit te KOSTT SH.A. Adresa e zyrës së regjistruar të Kompanisë është "Ndërtesa e Transmisionit dhe Dispeçimit, Isa Boletini Nr. 39, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës. Kosova shpalli pavarësinë e saj më 17 shkurt 2008. Në përputhje me Ligjin Nr. 03 / L-087 të datës 13 Qershor 2008 mbi "Ligjin për Ndërmarrjet Publike", Sistemi i Transmisionit dhe Operatori i Tregut SH.A. është pronë e Republikës së Kosovës.

Aktivitetet kryesore të Kompanisë janë menaxhimi dhe funksionimi i sistemit të transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë dhe janë përgjegjës për transmetimin e energjisë elektrike në rrjetet kryesore elektrike të tensionit të lartë. Si një operator i tregut Kompania është gjithashtu përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e tregtisë në energji elektrike dhe menaxhon procesin e zgjidhjes. Më 31 Dhjetor 2022 Kompania ka 348 punonjës (2021: 347)

2 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL TË RËNDËSISHME

Politikat kryesore të kontabilitetit të miratuara gjatë përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare janë dhënë më poshtë.

2. 1 BAZA E PËRGADITJES DHE DEKLARATA E PAJTUESHMËRISË

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), duke qenë standarde dhe interpretime të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNEK").

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e matjes të specifikuara nga SNRF-të për secilin lloj të pasurisë, detyrimit, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë përshkruar më plotësisht në politikat e kontabilitetit më poshtë.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon përdorimin e vlerësimeve të caktuara kritike të kontabilitetit. Ai gjithashtu kërkon që menaxhmenti të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave të kontabilitetit të Kompanisë. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë shpalosur në Shënimin 3: Gjykimi i rëndësishëm dhe burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit.

Pasqyrat financiare janë përgatitur që nga dhe për vitet e përfunduara më 31 Dhjetor 2022 dhe 2021. Të dhënat aktuale dhe krahasuese të shprehura në këto pasqyra financiare shprehen në mijëra Euro, përveç nëse përcaktohet ndryshe. Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese janë riklasifikuar për t'u përshtatur me ndryshimet në prezantim për vitin.

Pasqyrat financiare paraqiten në Euro ("EUR"), e cila është monedha prezantuese dhe funksionale e Kompanisë.

2. 2 PARIMI VIJIMËSISË

Gjatë vitit financiar aktual, Kompania ka raportuar një fitim prej 794 mijë euro krahasuar me një humbje prej 26,647 mijë euro në vitin paraprak.Ky përmirësim në performancën financiare të Kompanisë ishte kryesisht për shkak të granteve të qeverisë për të mbuluar humbjet dhe rritjen e çmimit të energjisë. Në humbjen operative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 janë përfshirë shpenzimet për energjinë në komunat veriore të Republikës së Kosovës në vlerë prej 63,178 mijë euro (31 dhjetor 2021: 41,806 mijë euro).Këto shpenzime nuk janë shpenzime të kompanisë në rrjedhën normale të operimit, megjithatë kompania është e obliguar t'i paguajë në bazë të Ligjit 05/L-081 për energjinë elektrike dhe licencës së lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, në bazë të së cilës kompania është përgjegjëse për balancimin e sistemit energjetik. Gjatë vitit 2022, qeveria ka dhënë grante në vlerë prej 57,500 mijë euro, e cila mbuloi një pjesë të konsiderueshme të humbjeve të shkaktuara të energjisë në komunat veriore. Shpenzimet e mbetura janë mbuluar nga kompania. Menaxhmenti e ka ngritur këtë çështje në Kuvendin e Kosovës dhe në Qeverinë e Kosovës dhe aktualisht është në pritje të një rezolute që do ta lironte kompaninë nga barra e lidhur me këto shpenzime.

Menaxhmenti po monitoron nga afër këta faktorë të mësipërm dhe do të vazhdojë të zbatojë masat e duhura për të zbutur ndikimin e tyre të mundshëm në operacionet dhe performancën financiare të Kompanisë

Bazuar në performancën aktuale financiare të Kompanisë dhe veprimet e ndërmarra nga drejtimi për të ruajtur supozimin e vazhdimësisë, menaxhmenti beson se është e përshtatshme të përgatiten pasqyrat financiare mbi bazën e vijimësisë.

2. 3 STANDARDET E REJA APO TË NDRYSHUARA KONTABËL DHE INTERPRETIMET E ADOPTUARA

Kompania ka adoptuar të gjitha Standardet dhe Interpretimet e reja ose të ndryshuara të kontabilitetit të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ('BSNEK') që janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit. Miratimi i këtyre standardeve dhe interpretimi nuk kishte ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Kompanisë.

- Standardet dhe ndryshimet e mëposhtme të reja u bënë efektive në 1 Janar 2022:
- Referenca në Kuadrin Konceptual (Ndryshimet në SNRF 3)
- Covid-19 – Koncesionet e Qirasë përtej 30 Qershorit 2021 (Ndryshime në SNRF 16)
- Kontratat e vështira – Kostoja e përmbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37)
- Pasuritë afatgjata materiale, impiantet dhe pajisjet: të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)
- Përmirësimet vjetore të standardeve të SNRF - Cikli 2018-2020 (SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK 41)

STANDARDET, NDRYSHIMET DHE INTERPRETIMET NË STANDARDET EKZISTUESE QË NUK JANË EFEKTIVE OSE NUK JANË ADOPTUAR MË HERËT NGA KOMPANIA

Disa standarde dhe interpretime të caktuara të kontabilitetit të cilat jane publikuar, nuk janë të detyrueshme për periudhat raportuese deri 31 Dhjetorit 2022 dhe nuk janë adoptuar më herët nga Kompania. Këto standarde, ndryshime dhe interpretime nuk pritet të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Kompanisë në periudhat aktuale ose të ardhshme të raportimit dhe në transaksionet e ardhshme të parashikueshme.

2.4 NJOHJA E TË ARDHURAVE

E hyra nga shitja njihet në shumën që reflekton vlerësimin për të cilën kompania pritet të jetë e thirrur në shkëmbimin e të mirave apo shërbimeve te klienti. Për çdo kontratë me klient, kompania: identifikon kontratën me klientin; identifikon obligimet në kontratë; përcakton çmimin e transaksionit që merr në llogari vlerësimet e ndryshme dhe vlerën në kohë të parasë; alokon çmimin e transaksionit për detyrimet e veçanta në bazë të çmimit të shitjes së pavarur të çdo malli apo shërbimi që do të dërgohet; dhe njeh të hyrat kur ose secili obligim është përfunduar në një mënyrë që përshkruan transferin e mallrave ose shërbimeve të premtuara.

Vlerësimet e ndryshme brenda çmimit të transaksionit, nëse ka, reflektojnë koncesionet të siguruara te klienti siç janë zbritjet, rabatet dhe rimbursimet, çdo bonus potencial i arkëtueshëm nga klienti dhe çdo ngjarje tjetër kontingjente. Vlerësimet e tilla përcaktohen duke përdorur ose metodën e 'vlerës së pritur' ose metodën e 'vlerës më të mundshme për të ndodhur'. Matja e vlerësimeve të ndryshme i nënshtrohet një parimi kufizues prej ku shitja do të njihet vetëm deri në shkallën që është shumë e mundshme që një kthim domethënës në vlerën e grumbulluar të shitjes nuk do të ndodhë. Vlerësimi i kufizuar vazhdon derisa pasiguria e shoqëruar me vlerësimin e ndryshëm zgjidhet më pas. Shumat e pranuara që i nënshtrohen parimit të kufizuar njihen fillimisht si të hyra të shtyra në formë të një detyrimi të ndarë rimbursues.

Të ardhurat nga Sistemi i Transmisionit

Të ardhurat nga Sistemi i Transmisionit janë të ardhura nga tarifat për transmetimin e energjisë përmes rrjetit të transmisionit. Të ardhurat nga operatori i sistemit janë kryesisht të ardhura me Kompanin e Furnizimit me Energji Elektrike të Kosovës (KESCO). Tarifat e ngarkuara janë për shërbimet e mirëmbajtjes dhe zhvillimit të transmetimit të energjisë elektrike.

Të ardhurat nga Operatori i Sistemit

Të ardhurat nga Operatori i Sistemit janë të ardhurat nga tarifat të cilat gjenerohen për funksionimin e sistemit. Të ardhurat atje janë kryesisht nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) dhe KESCO. Tarifat tarifohen për operacione efikase të rrjetit, përfshirë rrjetin ndërkombëtar.

Të ardhurat nga Operatori I Tregut

Të ardhurat nga Operatori i Tregut janë të ardhurat e gjeneruara nga funksionimi i tregut në përputhje me ligjin për energjinë dhe gjithashtu nga shërbimet nga administrimi i tregut të centralizuar të energjisë elektrike në Kosovë. Të hyrat përfshijnë gjithashtu shërbimet për balancimin e bilanceve jo-energjetike.

Të ardhurat nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE)

Ligji për Energjinë Elektrike LIGJI Nr. 05 / L - 085 ndër të tjera detyron Operatorin e Tregut për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga BRE. Në këtë kontekst, Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka miratuar Rregulloren për Skemën e Mbështetjes, e cila përcakton që Gjeneruesit e BRE-ve të pranuar në Skemën e Mbështetjes ose nën Kornizën e Rregulluar kanë të drejtë të shesin gjenerimin e tyre të energjisë elektrike tek Operatori i Tregut, përmes Marrëveshjes së Blerjes së Energjisë

Interesi

E hyra nga interesi njihen kur interesi ndodh duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kjo është një metodë e kalkulimit të kostos së amortizuar së një pasurie financiare dhe e alokimit të hyrave të interesit nëpër periudhën relevante duke përdorur normën e interesit efektiv, normë e cila saktësisht zbret pranimet e keshit të parashikuara përmes pritshmërisë së pasurisë financiare për vlerën neto kontabël të pasurisë financiare.

Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera njihen kur pranohen ose kur përcaktohet e drejta për të marrë pagesa.

2. 5 SHPENZIMET OPERATIVE

Shpenzimet e operimit njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse gjatë përdorimit të shërbimit ose në datën e origjines.

2. 6 HUMBJET E ENERGJISË

Humbja në transmisionin e energjisë njihet në kohën e ndodhjes dhe llogaritet në bazë mujore. Humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e transmisionit paraqiten si një ndryshim midis energjisë elektrike të matur në hyrjen e rrjetit të transmisionit dhe energjisë së matur në daljen e rrjetit të transmisionit. Diferenca llogaritet në baza mujore. Bazuar në diferencën e matur, humbjet faturohen dhe kompania është përgjegjëse për kompensimin e shumave të faturuara.

2. 7 KLASIFIKIMI AFATËSHKURTË DHE AFATËGJATË

Pasuritë dhe detyrimet janë të paraqitura në pasqyrën e pozitës financiare duke u bazuar në klasifikimin afatshkurtë dhe afatgjatë.

Një pasuri klasifikohet si afatshkurtë kur: ose pritet të realizohet prej saj ose qëllimi është për t'u shitur ose për t'u konsumuar në ciklin normal operativ; mbahet për qëllime primare të tregtimit; pritet të realizohet brenda 12 muajve pas periudhës raportuese; ose pasuria është kesh apo ekuivalent i keshit përveç nëse ndalohet për t'u këmbyer apo për t'u përdorur për kryerjen e një detyrimi për më së paku 12 muaj pas periudhës raportuese. Të gjitha pasuritë tjera klasifikohen si afatgjatë.

Një detyrim klasifikohet si afatshkurtë kur: ose pritet të kryhet në ciklin normal operativ; mbahet për qëllime primare të tregtimit; pritet të kryhet brenda 12 muajve pas periudhës raportuese; ose nuk ka të drejtë të pakushtëzuar për ta shtyrë kryerjen e detyrimit për më së paku 12 muaj pas periudhës raportuese. Të gjitha detyrimet tjera klasifikohen si afatgjatë.

Tatimi i shtyrë si pasuri dhe detyrime gjithnjë klasifikohet si afatgjatë.

2. 8 PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET

Zërat e ndërtesave, impianteve dhe paisjeve më 1 Janar 2006 janë rideklaruar me koston e konsideruar minus amortizimin dhe zhvlerësimin e akumuluar, ndërsa zërat e ndërtesave pronave dhe paisjeve të blera pas 1 janarit 2006 deklarohen me kosto minus amortizimin dhe zhvlerësimin e akumuluar, nëse ka.

Kostoja e konsideruar përfaqëson vlerat fillestare të pasurive të vlerësuara nga një konsulent i pavarur në kohën e shndërrimit nga një Korporatë në një Shoqëri Aksionare më 1 Janar 2005. Këto pasuri njihen si një kontribut transfer i pasurive nga KEK SH.A. në data e korporatës (Shënimi 13).

Shuma e mbajtur për secilin komponent të llogaritur për, si pasuri e ndarë nuk njihet kur zëvendësohet. Të gjitha rregullimet dhe mirëmbajtjet janë të ngarkuara me fitim apo humbje gjatë periudhës së raportimit në të cilën ata janë shkaktuar.
Rritja në vleren kontabel që rrjedh nga rivlerësimi i pronave, impianteve dhe pajisjeve janë të regjistruara, neto nga taksat, në të hyra të tjera gjithëpërfshirëse dhe të rezervave të akumuluara të ekuitetit të aksionarëve. Deri në pikën ku rritja kthehet në rënie më parë e njohur si humbje ose fitim, rritja fillimisht është njohur si fitim apo humbje. Rëniet që kthejnë rritjen e mëparshme të pasurisë të njëjtë njihen fillimisht në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse deri në pikën e shtesës së mbetur të atribueshme për pasurinë; të gjitha rëniet e tjera janë të ngarkuara në humbje ose fitim. Çdo vit, dallimi mes zhvlerësimit të bazuar në shumën kontabel të rivlerësuar të pasurisë të ngarkuar me fitim apo humbje dhe zhvlerësimit të bazuar në çmimin origjinal të pasurisë, neto nga tatimi, riklasifikohet nga shtesa e rivlerësimit të fitimit të shpërndarë të pronës, impianteve dhe pajisjeve.
Vlera e mbetur dhe jeta e dobishme e pasurive rishikohen, dhe rregullohen nëse janë të përshtatshme, në fund të secilës periudhë të raportimit.
Shuma e mbajtur e një akti regjistrohet menjëherë tek shuma e rimarr nëse shuma e bartur e pasurisë është më e madhe se shuma e njehsuar e rimarrë.

Fitimet dhe humbjet në dispozicion janë të përcaktuara duke krahasuar procedura me shumën e bartur. Këto përfshihen në fitim apo humbje. Kur aktet e rivlerësuara shiten, është politikë e Kompanisë që çdo shumë të transferohet përfshirë edhe rezervat e tjera në lidhje me ato pasuri në mënyrë që të rikthehen fitimet.

Zhvlerësimi njehsohet duke përdorur metodën e bazës lineare për të caktuar koston apo shumën e rivlerësuar, neton e vlerës së mbetur, përgjatë jetës së mbetur të dobishme ose, në rastin e kontratës së qirasë dhe disa impiante dhe pajisje me qira, kushti për qira më të shkurtë vlen si në vijim:

Lloji i pasurisë	**Jetëgjatësia e dobishme**
Ndërtesat dhe rrjeti i transmetimit	2-50 Vjet
Impiante dhe makineri	7-15 Vjet
Mobilje, orendi dhe pajisje	2-16 Vjet
Automjetet	5-10 Vjet

2. 9 PASURITË E PAPREKSHME

Pasuritë e paprekshme të Kostt SH.A konsistojnë nga licenca dhe programe (softuerike) me jetëgjatësi të vlefshme të kufizuar. Në njohje fillestare, pasuritë e paprekshme të kërkuara veçmas maten me kosto. Kostoja e një pasurie të kërkuar veçmas përfshin çmimin e saj të blerjes, duke përfshirë këtu edhe detyrimet e importimit dhe taksa të blerjes që nuk rimburësohen, pas zbritjes të tregtisë me ulje apo zbritje dhe çdo kosto drejtpërdrejt i atribueshëm të pasurisë të përgatitur për përdorimin e paraparë të tij.

Pas regjistrimit primar, pasuritë e paprekshme barten me kosto më të ulët nga amortizimi i grumbulluar dhe humbja nga dëmtimet. Amortizimi regjistrohet në bazë lineare për jetëgjatësinë e vlefshme të llogaritur. Jetëgjatësia e vlefshme e llogaritur dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të secilës periudhë të raportimit me ndikimin e çfarëdo ndryshimin në vlerësim duke u llogaritur për, në baza të ardhshme. Jetëgjatësia e vlefshme në vijim janë aplikuar:

Lloji i pasurisë	**Jetëgjatësia e dobishme**
Softueri	5 Vite

Një pasuri e paprekshme çregjistrohet për arsye se është jashtë përdorimit, ose kur nuk priten përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi apo asgjësimi i tij. Fitimet ose humbjet që rrjedhin nga mosnjohja e një pasuri jo-materiale njihen në fitim ose humbje kur pasuria çregjistrohet.

2. 10 ZHVLERËSIMI I PASURIVE JO-FINANCIARE

Zhvlerësimi i pronës, impianteve, pajisjeve dhe mjeteve të paprekshme me jetë të caktuar të përdorimit

Vlera kontabël e këtyre pasurive ndryshon në çdo datë raportimi për shumën e zhvlerësimit dhe kur një aset është zhvlerësuar, njihet shpenzim përmes pasqyrës së fitimit ose humbjes në shumën e vlerësuar të rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë neto kontabël dhe vlera e tregut minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit të pasurisë individuale ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare. Shuma e rikuperueshme përcaktohet për një aset individual, përveç nëse pasuria nuk gjeneron rrjedha monetare të cilat janë kryesisht të pavarura nga ato të pasurive ose grupeve të tjera të pasurive. Në këtë rast, shuma e rikuperueshme përcaktohet për njësinë gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i takon pasuria.

Vlera në përdorim është vlera e tanishme e vleresimit te ardhshem të rrjedhës së parasë të pasurisë/njesisë. Vlerat e tanishme janë të llogaritura duke përdorur normat e zbritjes para tatimit që pasqyrojnë vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të asaj pasurie/njësie dëmtimet e të cilës janë duke u llogaritur.

Humbjet nga zhvlerësimi për njësitë gjeneruese të mjeteve monetare alokohen së pari kundër emrit të mirë të njësisë dhe më pas pro rata midis aktiveve të tjera të njësisë. Rritjet e mëpasshme në shumën e rikuperueshme të

shkaktuara nga ndryshimet në vlerësimet janë kredituar në fitim ose humbje në masën që ata e kthejnë zhvlerësimin.

2.11 INVESTIMET NE SHOQERI DHE SIPERMARRJE TE PERBASHKETA

Investimet ne shoqeri dhe sipermarrje te perbashketa llogariten duke përdorur metodën ekuitetit. Vlera kontabël e investimit në shoqeri dhe sipermarrje te perbashketa rritet ose zvogëlohet për të njohur pjesën e Kompanisë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse të shoqërisë dhe sipermarrjeve te perbashketa, rregulluar kur është e nevojshme për të siguruar qëndrueshmëri me politikat kontabël të Kompanisë.

Fitimet dhe humbjet e parealizuara në transaksionet midis Kompanisë dhe shoqerive dhe sipërrmarrjeve të përbashkëta eliminohen në masën e interesit të Kompanisë në ato njësi ekonomike. Kur eliminohen humbjet e parealizuara, pasuria themelore testohet gjithashtu për zhvlerësim.

2.12 GRANTE QEVERITARE

Grantet qeveritare nuk njihen derisa të ketë siguri të arsyeshme se Kompania do të përmbushë kushtet që u bashkangjiten atyre granteve dhe se grantet do të merren.

Grantet qeveritare, kushti kryesor i të cilave është që Kompania duhet të blejë, ndërtojë ose përndryshe të përvetësojë pasurinë afatgjatë njihen si të ardhura të shtyra në pasqyrën e pozicionit financiar dhe transferohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes mbi një bazë sistematike dhe racionale gjatë jetës së dobishme të pasurisë.

Grantet e tjera qeveritare njihen si të ardhura gjatë periudhave të nevojshme për t'i krahasuar ato me kostot për të cilat synojnë të kompensohen, mbi një bazë sistematike. Grantet qeveritare që janë të arkëtueshme si kompensim për shpenzimet ose humbjet e ndodhura tashmë ose me qëllim të dhënies së mbështetjes së menjëhershme financiare për Kompaninë pa ndonjë kosto të lidhur në të ardhmen njihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato bëhen të arkëtueshme.

2.13 INVENTARI

Inventari mbahet në pasqyrën e pozicionit financiar në koston më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme. Kosto e inventarit përcaktohet duke përdorur metodën e mesatarës së ponderuar.

Shlyerja është bërë për njësitë e vjetërsuara dhe të dalura nga përdorimi, bazuar në përdorimin e pritshëm të tyre në të ardhmen dhe vlerës neto të realizueshme.

Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes gjate aktivitetit normal të biznesit pas llogaritjes së të gjitha shpenzimeve të mëtejshme të kompletimit dhe shitjes.

2.14 INSTRUMENTET FINANCIARE

Njohja dhe çregjistrimi

Pasuritë dhe detyrimet financiare njihen kur Kompania bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit financiar.

Pasuritë financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga pasuria financiare, ose atëherë kur bëhet transferimi i pasurive financiare dhe të gjitha rreziqeve dhe përfitimeve thelbësore. Një detyrim financiar çregjistrohet atëherë kur ai shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

Klasifikimi dhe matja fillestare e pasurive financiare

Përveç të arkëtueshmeve tregtare të cilat nuk përmbajnë në vete përbërës të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmim të transaksionit në pajtueshmëri me SNRF 15, të gjitha pasuritë e tjera financiare fillimisht maten me vlerë të drejtë, të korrigjuar për kostot e transaksionit (aty ku është e zbatueshme).

Pasuritë financiare, më përjashtim të pasurive financiare të paracaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- Pasuritë financiare me kosto të amortizuar.

- Pasuritë financiare me vlera të drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL).
- Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Në periudhat e paraqitura Kompania nuk ka asnjë aktiv financiar të kategorizuar si FVOCI dhe (FVTPL).

- Klasifikimi përcaktohet nga të dyja:
- Modeli i biznesit së njësisë ekonomike në menaxhimin e pasurisë financiare.
- Karakteristikat e rrjedhës së parasë kontraktuale të pasurisë financiare.

Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me pasuritë financiare të cilat njihen në fitim ose humbje janë përfshirë brenda shpenzimeve financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjerë financiarë, me përjashtim të zhvlerësimit të të arkëtueshmeve tregtare, të cilat paraqiten brenda shpenzimeve të tjera.

Matja e mëpasshme e pasurive financiare

Pasuritë financiare me kosto të amortizuar

Pasuritë financiare maten me kosto të amortizuar atëherë kur ato plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë të përcaktuara si FVTPL):

- ato janë të mbajtura brenda një modeli biznesor, qëllimi i së cilit është mbajtja e pasurive financiare dhe grumbullimi i flukseve monetare kontraktuale
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare prodhojnë flukse të mjeteve monetare, pagesa e kryegjësë dhe interesit, të shumës kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto pasuri maten me kosto të amortizuar përmes metodës efektive të interesit. Zbritja nuk aplikohet atëherë kur efekti i zbritjes është jo material. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj, të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera përfshihen tek instrumentet financiare dhe janë klasifikuar si kredi dhe llogari të arkëtueshme më 31 Dhjetor 2022, pa ndonjë ndryshim në matje.

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL)

Pasuritë financiare që janë mbajtur në një model të ndryshëm biznesi përveç "mbajtjes për të mbledhur" ose "mbajtje për të mbledhur dhe shitur", kategorizohen në vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes. Për më tepër, pavarësisht nga modeli i biznesit të pasurive financiare, per të cilat paratë e kontratës nuk janë vetëm pagesa të principalit dhe interesi llogariten në FVTPL. Të gjitha instrumentet financiare derivative hyjnë në këtë kategori, përveç atyre të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtës, për të cilat zbatohen kërkesat e kontabilitetit mbrojtës.

Pasuritë në këtë kategori maten me vlerën e drejtë - me fitimet ose humbjet e njohura në fitim ose humbje. Vlerat e drejta të pasurive financiare në këtë kategori përcaktohen duke iu referuar transaksioneve të tregut aktiv ose duke përdorur një teknikë vlerësimi kur nuk ekziston një treg aktiv.

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI)

Llogaritë e Kompanisë përfshinë pasuritë financiare të FVOCI atëherë kur ato plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen në një model biznesi, objektivi i të cilit është "mbajtja për të mbledhur" e flukseve monetare shoqëruese dhe shitja e tyre si dhe
- kushtet kontraktuale të këtyre pasurive financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e kryegjësë dhe interesit të shumës kryesore të papaguar.

Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ) do riklasifikohet pas mosnjohjes së pasurisë.

Zhvlerësimi i pasurive financiare

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 vënë më tepër në përdorim informacionet e së ardhshmes me qëllim të njohjes së humbjeve të pritura të kreditit - 'modelin e humbjes së pritur të kreditit (HPK)'. Kompania merr në konsideratë një gamë më të gjerë informacionesh, me rastin e vlerësimit së rrezikut të kredisë dhe matjes së humbjeve të pritura të kreditit, përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet e tanishme, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetshme që kanë ndikim në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje progresive, dallimi midis tyre bëhet si vijon:

- instrumentet financiare që nuk kanë pësuar përkeqësim të dukshëm të cilësisë së kredisë nisur që nga njohja fillestare, ose ato me rrezik të ulët të kredisë ('Faza 1') dhe
- instrumentet financiare që cilësinë e kredisë e kanë përkeqësuar dukshëm që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë të së cilave është jo i ulët ('Faza 2').
- 'Faza 3' mbulon pasuritë financiare të cilat posedojnë dëshmi objektive të zhvlerësimit të tyre, në datën e raportimit.
- • Humbjet e pritshme të kredisë 12-mujore njihen për Fazën 1 ndërsa 'humbjet e pritshme gjatë gjithë jetës' njihen për Fazën 2 dhe 3. Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera

Kompania vë në përdorim një qasje të thjeshtuar në kontabilizimin e të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera, dhe regjistron lejimet për humbjet si jetëgjatësia e humbjeve të pritura të lejimeve për të arkëtueshmet. Këto janë mangësitë e pritura tek flukset e mjeteve monetare kontraktuale, marrë në konsideratë potencialin e mosplotësimit në çdo moment përgjatë ciklit jetësor të instrumentit financiar. Kompania përdor përvojën e saj, treguesit e jashtëm dhe informacionet progresive për llogaritjen e humbjeve të pritura të klejimeve për llogaritë e arkëtueshme duke përdorur matricën e provizionit. Kompania vlerëson zhvlerësimin e të arkëtueshmeve tregtare të saj në baza kolektive, meqë ato kanë karakteristika të përbashkëta të rrezikut të kredisë, të cilat janë të grupuara në bazën e ditëve të kaluara. Referojuni Shënimit të Rrezikut të Kredisë për një analizë të detajuar të asaj se si aplikohen kërkesat e zhvlerësimit të SNRF 9.

Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare

Detyrimet financiare të Kompanisë përfshijnë detyrimet tregtare dhe të pagueshmet të tjera, në datat e raportimit.

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe, atëherë kur është e zbatueshme, përshtaten për kostot e transaksionit, përveç nëse detyrimi financiar është paracaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nga Kompania.

Më pastaj, detyrimet financiare maten me kosto të amortizuar përmes metodës së interesit efektiv, përveç derivativave dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në FVTPL, të cilat mbahen më pas me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative të cilat janë të paracaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse).

Të gjitha pagesat e ndërlidhura me interes, dhe, atëherë kur është e zbatueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti të cilat raportohen në fitim ose humbje përfshihen tek kostot financiare ose tek të ardhurat financiare.

2.15 TË ARKËTUESHMET TREGTARE DHE TË TJERA

Të arkëtueshmet tregtare fillimisht njihen me vlerë të drejtë dhe më pas maten me kosto të amortizuar përmes metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë. Të arkëtueshmet tregtare në përgjithësi kanë afatin e shlyerjes brenda 30 deri 90 ditë.

Për matjen e humbjeve të pritur të kredisë, Kompania ka zbatuar qasjen e thjeshtuar, e cila bën kompensimin e humbjeve të pritshme të kredisë përgjatë gjithë jetëgjatësisë së saj. Për të matur humbjet e pritura të kredisë, të arkëtueshmet tregtare janë grupuar në bazë të ditëve të vonuara.

Të arkëtueshmet e tjera njihen me kosto të amortizuar, duke zbritur çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë.

2.16 PARAJA DHE EKUIVALENTËT E SAJ

Vetëm për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë para të gatshme, dhe paranë të mbajtur në një llogari aktuale në ndonjë institucion financiar. Mbitërheqjet bankare janë të paraqitura tek huamarrjet në detyrimet afatshkurtra në pasqyrën e pozicionit financiar.

2.17 KOSTOT E HUAMARRJES

Kostot e huamarrjes kryesisht përbëhen nga interesi për huazimet e Kompanisë. Kostot e huamarrjes që lidhet drejtpërdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një pasurie të kualifikuar janë kapitalizuar gjatë periudhës kohore që është e nevojshme për të përfunduar dhe përgatitur pasurinë për qëllim përdorimi ose shitjeje. Kostot e tjera të huamarrjes janë shpenzuar në periudhën në të cilën ato janë kryer dhe raportuar si "kostot e financave".

2.18 TË PAGUESHMET TREGTARE DHE TË TJERA

Këto shuma përfaqësojnë detyrimet e papaguara për mallrat dhe shërbimet e ofruara ndaj Kompanisë para fundit të vitit financiar. Për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër, ato maten me kosto të amortizuar dhe nuk zbriten. Shumat janë të pasigurta dhe zakonisht paguhen brenda 30 ditëve që nga njohja a tyre.

2.19 DETYRIMET KONTRATUALE

Detyrimet e kontratës përfaqësojnë detyrimin e kompanisë për të transferuar mallra ose shërbime tek një klient dhe njihen atëherë kur një klient paguan konsideratën, ose atëherë kur Kompania bën njohjen e një të arkëtueshme me qëllim që të pasqyrojë të drejtën e pakushtëzuar të saj për shqyrtim (cilado që ndodh më parë) para se Kompania të ketë transferuar mallrat ose shërbimeve ndaj klientit.

2.20 TRANSAKSIONET NË VALUTË TË HUA

Pasuritë dhe detyrimet të valutës monetare të huaj përkthehen në monedhën funksionale të njësisë ekonomike duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në kurset e këmbimit pas datës së transaksionit njihen në fitim ose humbje (përveç kur klasifikohet në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse si rrjedhë e parasë nga instrumenti mbrojtës). Pasuritë dhe detyrimet jo-monetare që janë matur sipas kostos historike në një monedhë të huaj përkthehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Artikujt jo-monetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj (p.sh. Instrumentet e kapitalit në dispozicion për shitje) përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë përcaktohet.

2.21 PERFITIMET PENSIONALE

Kompania nuk jep asnjë provizion dhe nuk ka asnjë detyrim për pensionet e punonjësve për sa i përket kontributeve të paguara në planin e pensionit të detyrueshëm, Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trust).

2.22 TATIMI NË FITIM

Tatimi është kalkuluar ne pasqyrat financiare në përputhshmëri me ligjin aktual në fuqi të Kosovës mbi tatimet, Ligji nr. 06/L-105 "Tatimi në të Ardhura të Korporatave" në zbatim prej 5 Gusht 2019. Norma e tatimit mbi të ardhurat e tatueshme të korporatave është 10%.

Tatimi aktual llogaritet në bazë të pritshmërisë së fitimit të tatueshëm për vitin duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi kontabël ose për shkak se disa të ardhura dhe shpenzime nuk janë të tatueshme ose të zbritshme, ose për shkak se në kohën kur janë të tatueshme ose të zbritshme dallon trajtimi sipas tatimeve dhe kontabilitetit.

Shpenzimi i tatimit për periudhën përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Tatimi njihet në fitim ose humbje, përveç nëse ajo lind nga transaksione ose ngjarje që janë njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, ose direkt në ekuitet. Në këtë rast, tatimi njihet në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse ose direkt, respektivisht në ekuitet. Kur tatimi rrjedh nga kontabilizimi fillestar për një kombinim biznesi, ai është përfshirë në kontabilitet për kombinimin e biznesit. Tatimet përveç tatimit mbi të ardhurat regjistrohen brenda shpenzimeve operative.

Tatimi i shtyrë njihet në diferencat midis vlerës së bartur të pasurive dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazës tatimore përkatëse të përdorura në llogaritjen e fitimit të tatueshëm dhe kontabilizohen duke përdorur metodën e obligimeve të bilancit. Detyrimet tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e

përkohshme të tatueshme dhe pasuritë tatimore të shtyra njihen në masën që është e mundur që fitimet e tatueshme do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit mund të përdoren diferencat e përkohshme të zbritshme.

Vlera kontabël e pasurive tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë të pasqyrës të pozicionit financiar dhe reduktohen deri në masën që nuk është më e mundur që fitimi i tatueshëm i mjaftueshëm do të jetë në dispozicion për të lejuar të gjithë ose një pjesë të pasurisë që të mbulohet.

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur normën tatimore që pritet të aplikohen në periudhën kur shlyhet detyrimi ose pasuria e realizuar. Tatimi i shtyrë ngarkohet apo kreditohet në fitim ose humbje, përveç kur ka të bëjë me artikuj të ngarkuar ose kredituar direkt në ekuitet, ku tatimi I shtyrë gjithashtu ballafaqohet me ekuitet.

Pasuritë dhe detyrimet e shtyra tatimore kompensohen kur ekziston një e drejtë ligjore për të kompensuar pasuritë tatimore aktuale kundrejt pasiveve tatimore aktuale dhe kur ato lidhen me tatimet mbi të ardhurat e mbledhura nga i njëjti organ tatimor dhe kompania ka për qëllim për të zgjidhur pasuritë e saj aktuale tatimore dhe detyrimet në një baza neto.

2.23 TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR

Të ardhurat, shpenzimet njihen neto nga shuma e tatimit mbi vlerën e shtuar, përveç kur tatimi mbi vlerën e shtuar nga blerja e pasurive ose shërbimeve nuk është e rimbursueshme nga organet tatimore, në të cilin rast vlera e shtuar është e njohur si pjesë e shpenzimeve për blerje ose si pjesë e kostos sipas rastit; dhe

Shuma neto e TVSH e cila është e rikuperueshme, ose që duhet paguar te autoritetet tatimore është përfshirë si pjesë e arkëtueshme ose detyrimeve në pasqyrën e pozicionit financiar.

2.24 PROVIZIONET

Një provizion njihet kur Kompania ka një obligim aktual si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, dhe është e mundur se një rrjedhje e përfitimeve ekonomike do të kërkohet për të shlyer obligimin, dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së obligimeve. Provizionet rishikohen për secilën pasqyrë në datën e pasqyrës së pozicionit financiar dhe rregullohen për të paraqitur parashikimin më të mirë. Kur efekti kohor i vlerës së parave është material, shuma e provizionit është vlera aktuale e shpenzimeve që pritet të kërkohen për të shlyer obligimin.

2.25 EKUITETI

Instrumentet e ekuitetit janë kontratat që i japin një interes të mbetur në pasuritë neto të Kompanisë. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Instrumentet e ekuitetit njihen në shumën e të ardhurave neto të marra të kostove drejtpërdrejt të atribueshme për transaksion. Për aq kohë sa këto të ardhura tejkalojnë vlerën nominale të aksioneve të emetuara ato kreditohen në një llogarinë e premisë së aksionev.

Kapitali aksionar
Kapitali aksionar përbëhet nga vlera e drejtë monetare e kontributeve nga aksionarët.

Fitimet e mbajtura
Fitimet e mbajtura përbehen nga fitimi I pashpëndarë nga periudha aktuale dhe ato të kaluara.

Rivlerësimi I rezervave
Rivlerësimi i rezervave - përfshin fitimet dhe humbjet nga rivlerësimi i pasurive, impianteve dhe pajisjeve.

Shpërndarje dividendë
Dividendët njihen si detyrime, kur ato deklarohen (d.m.th. dividendët janë të autorizuar siç duhet dhe nuk janë më në diskrecionin e njësisë ekonomike). Në mënyrë tipike, dividendët njihen si detyrime në periudhën në të cilën shpërndarja e tyre është aprovuar në mbledhjen e aksionarëve. Dividendët e ndërmjetëm njihen kur paguhen.

2.26 ZOTIMET DHE KONTIGJENCAT

Detyrimet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur përveç nëse një rrjedhje e mundshme e burimeve që materializojnë përfitimet ekonomike është e largët. Pasuritë kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur një rrjedhje e beneficioneve ekonomike është e mundshme.

Shuma e humbjes kontingjente është njohur si provizion nëse ka gjasa që ngjarjet në të ardhmen do ta konfirmojnë atë, detyrimin e pësuar në datën e pozicionit financiar dhe një vlerësim i besueshëm i shumës së humbjes së rezultuar të mund të bëhet.

2.27 TRANSAKSIONET ME PALËT E NDËRLIDHURA

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarët dhe drejtorët e Kompanisë, bashkë me njësitë që ata kontrollojnë, të cilët mund të ushtrojnë ndikim të rëndësishëm mbi operacionet dhe menaxhimin e kompanisë. Duke marrë parasysh çdo marrëdhënie ndërmjet palëve të lidhura, vëmendja është drejtuar në thelbin e marrëveshjes dhe jo thjesht formës ligjore.

2.28 NGJARJET PAS DATËS RAPORTUESE

Ngjarjet mëpasshme që ofrojnë informacion shtesë në lidhje me pozicionin e Kompanisë, në datën e pasqyrës së pozicionit financiar (ngjarjet rregulluese) reflektohen në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas periudhës raportuese që nuk janë ngjarje rregulluese shpalosen në shënime nëse janë materiale.

3 GJYKIME TË RËNDËSISHME DHE BURIME KYQE TË VLERËSIMIT TË PASIGURISË

Në zbatimin e politikave të kontabilitetit të Kompanisë, të cilat janë përshkruar në Shënimin 2 të këtyre pasqyrave financiare, nga menaxhmenti kërkohet të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime mbi vlerat bartëse të pasurive dhe detyrimeve që nuk janë lehtë të dukshme nga burimet tjera. Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura janë bazuar në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë që janë konsideruar të jenë relevantë. Rezultatet e tanishme mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në bazë të vazhdueshme. Rishikimet ndaj vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet nëse ai ndikon vetëm atë periudhë, ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme nëse rishikimi ndikon periudhat aktuale dhe të ardhshme.

Burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim

Vlerësimi i vlerës së drejtë të pronës, impianteve dhe pajisjeve

Siç përshkruhet në Shënimin 2.8 më lart, Kompania rishikon jetën e dobishme të vlerësuar të pronës, impianteve dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportuese. Çdo ndryshim në përdorimin e vazhdueshëm të pronave ose ndonjë faktor tjetër mund të ndikojë në jetën e dobishme të pasurive dhe si rrjedhojë mund të ndryshojë ndjeshëm vlerën kontabël të këtyre pasurive.

Zhvlerësimi i pasurive jo-financiare

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në shumën për të cilën vlera bartëse e pasurisë ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon shumën e rikuperueshme. Gjatë përcaktimit të shumës së rikuperueshme, Menaxhmenti vlerëson çmimet e pritshme dhe rrjedhën e parasë nga secila njësi gjeneruese të parasë dhe përcakton një normë të interesit të përshtatshme gjatë llogaritjes së vlerës aktuale të rrjedhës së parasë.

Inventari

Inventari vlerësohet me koston më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme. Kostoja e stoqeve njehësohet ndaj vlerës së llogaritur të realizueshme kur kostoja e saj nuk është më e rikuperushme, si në rastet kur stoqet janë të dëmtuar apo vjetërsohet pjesërisht apo plotësisht ose çmimet e tyre të shitjes kanë rënë. Në çdo rast, vlera e realizueshme paraqet vlerësimin më të mirë të shumës së rikuperushme, e cila bazohet në dëshminë më të besueshme të disponueshme në datën e raportimit, dhe në thelb përfshin vlerësime në lidhje me vlerën e pritshme të realizueshme në të ardhmen. Standatdet për përcaktimin e shumës të njehësuara për vlerën e realizueshme neto përfshin analizën e maturimit, vlerësimin teknik, dhe ngjarjet pasuese. Në përgjithësi, një proces i tillë i vlerësimit kërkon gjykim të rëndësishëm dhe mund të ndikoj materialisht në vlerën e bartur të inventarit në datën e raportimit.

Lejimi për humbjet e pritshme kreditore

Lejimi për vlerësimin e humbjeve të pritshme kreditore kërkon një shkallë vlerësimi dhe gjykimi. Ai bazohet në humbjen e pritur kreditore përgjatë gjithë jetëgjatësisë së kreditit, grupuar në bazë të ditëve të vonuara dhe bën supozime për të alokuar një normë të përgjithshme të pritur të humbjes së kredisë për secilin grup. Këto supozime përfshijnë përvojën e fundit të shitjeve dhe normat historike të grumbullimit.

SHËNIME (VAZHDIM)
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2022

4 PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET

	Toka	Ndërtesat dhe rrjeti i transmisionit	Impiantet dhe makineria	Automjete, mobilje dhe pajisje të tjera	Puna në Progres	Gjithsej
Kosto/ Kostot e konsideruara						
Më 1 JANAR 2021	**5,016**	**114,598**	**154,261**	**8,424**	**2,245**	**284,544**
Shtesat për vitin	46	351	47	143	685	**1,272**
Transferet nga Puna ne progres		1,430	213	84	(1,727)	-
Heqjet nga përdorimi	-	-	-	(3)	-	**(3)**
Transferimet në inventar	-	-	-	-	(101)	**(101)**
MË 1 DHJETOR 2021	**5,062**	**116,379**	**154,521**	**8,648**	**1,102**	**285,712**
MË 1 JANAR 2022	**5,062**	**116,379**	**154,521**	**8,648**	**1,102**	**285,712**
Shtesat për vitin	47	117	67	76	2,761	**3,068**
Transferet nga Puna ne progres	-	196	150	98	(444)	-
Heqjet nga përdorimi	-	-	(22)	-	-	**(22)**
Transferimet në inventar	-	-	-	-	(14)	**(14)**
MË 1 DHJETOR 2022	**5,109**	**116,692**	**154,716**	**8,822**	**3,405**	**288,744**
ZHVLERËSIMI I AKUMULUAR						
MË 1 JANAR 2021	-	(38,796)	(78,720)	(7,481)	-	(124,997)
Zhvlerësimi për vitin		(4,953)	(10,089)	(479)	-	**(15,521)**
At 31 DECEMBER 2021	**-**	**(43,749)**	**(88,809)**	**(7,960)**	-	**(140,518)**
At 01 JANUARY 2022	-	**(43,749)**	**(88,809)**	**(7,960)**	-	**(140,518)**
Zhvlerësimi për vitin	-	(5,009)	(10,011)	(306)	-	**(15,326)**
MË 1 DHJETOR 2022	-	**(48,758)**	**(98,820)**	**(8,266)**	-	**(155,844)**
VLERA NETO KONTABËL						
MË 1 DHJETOR 2021	**5,062**	**72,630**	**65,712**	**688**	**1,102**	**145,194**
MË 1 DHJETOR 2022	5,109	67,934	55,896	556	3,405	132,900

Shtesat dhe grantet në lidhje me asetet

Gjatë vitit që përfundoi më 31 dhjetor 2022 nuk kishte asnjë shtesë në lidhje me zërat e impianteve dhe pajisjeve të marra përmes Grantit.

Shpenzimet e zhvlerësimit që i referohet këtyre pasurive në vlerë prej 6,507 mijë euro (2021: 6,657 mijë euro) lirohet nga të ardhurat e shtyra dhe njihet si e ardhur nga granti në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (shih shënimin 14).

Shlyerjet

Që nga 31 Dhjetor 2022, bazuar në numërimin fizik vjetor të kryer në pronat, objektet dhe pajisjet, Kompania ka fshirë nga përdorimi pasuritë me vlerën kontabël bruto prej 22 mijë euro (2021: 3 mijë euro, kundrejt fitimit dhe humbjes aktuale, kostoja e së cilës arrin në 22 mijë euro (2021: 3 mijë euro).

Prona, impiantet dhe pajisjet e lëna pengë

Me 31 Dhjetor 2022 dhe 2021, nuk ka asnjë pronë, impiant dhe pajisje të lëna pengë. Të gjitha pasuritë përdoren për aktivitetet operative të Kompanisë.

5 PASURITË E PAPREKSHME

	Softueri EUR'000
Kosto	
MË 1 JANAR 2021	4,465
Shtesat për vitin	42
MË 31 DHJETOR 2021	**4,507**
MË 1 JANAR 2022	**4,507**
Shtesat për vitin	12
MË 31 DHJETOR 2022	**4,519**
AMORTIZIMI I AKUMULUAR	
MË 1 JANAR 2021	**(3,644)**
Shpenzimet e amortizimit për vitin	(256)
MË 31 DHJETOR 2021	**(3,900)**
MË 1 JANAR 2022	**(3,900)**
Shpenzimet e amortizimit për vitin	(212)
MË 31 DHJETOR 2022	**(4,112)**
VLERA NETO KONTABËL	
MË 31 DHJETOR 2021	**607**
MË 31 DHJETOR 2022	**407**

6 INVESTIMET NË SHOQERI

Më 5 tetor 2020, Kompania dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) kanë nënshkruar marrëveshjen për krijimin e Bursës Shqiptare të Energjisë - ALPEX. Procesi i krijimit të ALPEX filloi në Mars 2020 kur qeveria shqiptare nisi një tender për kompanitë e interesuara për t'u bërë aksionerë. Ajo u pezullua për shkak të pandemisë COVID-19 në Prill, dhe në fund të Qershorit u përzgjodhën aksionarët. Kompania zotëron 42,75% ndërsa administratori i OST Shqipëri zotëron 57,25%. Investimi në ALPEX llogaritet duke përdorur metodën e ekuitetit. Më 31 dhjetor 2022, investimi në shoqëri arriti në 617 mijë euro (2021: 868 mijë euro).

	2022 EUR '000	2021 EUR '000
Pasuritë afatgjata	123	120
Pasuritë afatshkurtër	1,349	1,692
	1,472	**1,812**
Detyrimet afatshkurtëra	38	13
Detyrimet afatgjata	-	-
	38	**13**
Asetet neto	**1,434**	**1,799**

	2022 EUR '000	2021 EUR '000
Te ardhurat	-	1
Shpenzimet	(452)	(257)
Humbja neto për vitin	**(452)**	**(256)**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	(1)
Humbja neto dhe të ardhurat totale gjithëpërfshirëse për vitin	**(452)**	**(257)**

SHËNIME (VAZHDIM)
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2022

Llogaritja e vlerës kontabël të investimit dhe ndryshimet gjatë vitit

	2022 EUR '000	2021 EUR '000
Pasuritë neto të shoqerisë	1,434	1,799
Proporcioni i interesit të pronësisë së Kompanisë në ALPEX	42.75%	42.75%
Vlera Kontabel e investimeve në shoqeri	617	774
Minus: Konsiderata e transferuar	(868)	(868)
Pjesa e akumuluar në fitim dhe humbje në shoqeri	(251)	(94)
Pjesa në fitim dhe humbje në shoqeri për vitin	**(251)**	**(94)**

Menaxhmenti i Kompanisë nuk e ka njohur pjesën e humbjes në shoqëri në shumën prej 94 mijë euro dhe i ka konsideruar efektet e pjesës në fitim dhe humbje në shoqëri për vitin si jomateriale dhe nuk e ka njohur efektin për vitin përfunduar 31 dhjetor 2021 dhe si rrjedhojë shuma kontabël e investimit në pjesëmarrje ka mbetur 868 mijë euro.

Për fundin e vitit 2022 Kompania ka njohur pjesën e humbjes në shoqëri në vlerë prej 251 mijë euro dhe kjo shumë ka ulur vlerën kontabël të investimit në shoqëri.

	2022 EUR '000	2021 EUR '000
Më 1 Janar	**868**	**868**
Konsideratat e dhëna	-	-
Dividentët e pranuar	-	-
Pjesa e fitimit dhe humbjes në shoqëri	(251)	
Më 31 Dhjetor	**617**	**868**

7 INVESTIMET FINANCIARE

Më 4 korrik 2012 një kompani u themelua dhe u regjistrua si Kompania Projektuese Ekipore me Përgjegjësi të Kufizuar me përgjegjësi për krijimin e një Zyre të Koordinuar të Ankandit në Evropën Juglindore d.o.o, me vendndodhje në Podgorica (CAO SEE). Është themeluar nga TEL (Rumania), Eles (Sllloveni), HEP OST (Kroaci), BIH ISO (Bosnjë dhe Hercegovinë), MEPSO (Maqedoni), OST (Shqipëri), HTSO (Greqi), TEIAS (Turqi) dhe KOSTT (Kosovë). Këto kompani kanë kontribuar me 30% në kapitalin aksionar të këtij entiteti, ndërsa 70% në kapitalin aksionar kanë kontribuar institucionet ndërkombëtare të financimit (BERZH, KfW dhe USAID).

Kompania ka investuar një shumë prej 28 mijë euro në kapitalin aksionar të CAO SEE më 4 korrik 2012 që përfaqëson 1% të aksioneve. Gjatë vitit 2014 kapitali aksionar i CAO SEE është rritur dy herë dhe ka kontribuar në rritjen e kapitalit në vlerë prej 40 mijë euro. Përqindja e zotërimit të KOSTT-it më 31 Dhjetor 2022 ishte 1% (31 dhjetor 2021: 1%).

SHËNIME (VAZHDIM)
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2022

8 STOQET

	2022 EUR '000	2021 EUR '000
Pjese reserve	3,623	3,714
Materialet dhe të shpenzueshmët	954	919
Të tjera	118	122
Karburant dhe lubrifikantë	28	9
	4,723	**4,764**
Minus: Provizioni për zhvlerësim	(316)	(316)
	4,407	**4,448**

Më 31 Dhjetor 2022 nuk ka artikuj të pranuara përmes granteve që janë përfshirë në stoqe.

.

9 TË ARKËTUESHMET TREGTARE DHE TË TJERA

Të arkëtueshmet tregtare	2022 EUR '000	2021 EUR '000
Debitorët tregtarë	40,156	26,769
	40,156	**26,769**
Minus: Provizioni për zhvlerësim	(1,331)	-
	38,825	**26,769**
Huadhëniet dhe parapagimet		
Parapagimet ndaj furnitorëve	1,185	1,685
	1,185	1,685
	40,010	**28,454**
Të arkëtueshmet e tjera		
Të arkëtueshmet për jobalancat	43,625	48,612
Minus: Provizioni për zhvlerësim	(1,681)	-
	41,944	**48,612**
TVSH e arkëtueshme		-
Avanset për punëtorët	211	222
Të arkëtueshme tjera	1,936	135
	44,091	**48,969**
GJITHSEJ TË ARKËTUESHME TREGTARE DHE TË TJERA	84,101	**77,423**

Të arkëtueshmet për jobalancat

* Sipas Ligjit për energji elektrike dhe licencave, Kostt SH.A përveç tjerash është përgjegjëse edhe për balancimin e sistemit te energjisë elektrike. Ne nenin 16 te Ligjit për energji elektrike ne paragrafin 1.19 te këtij neni Operatori I Sistemit është përgjegjës për " balancimin e sistemit te energjisë elektrike ne harmoni me Kodin e rrjetit dhe Rregullat e tregut". Meqenëse energjia elektrike si produkt i cili liferohet ne kohe reale çdo here lajmërohet diference ne mes sasisë se kontraktuar dhe sasisë se prodhuar gjegjësisht te konsumuar.
Diferenca ne mes energjisë se kontraktuar për liferim dhe energjisë se liferuar te matur e një nga një pale tregtare quhet jo balancë e palës dhe pala tregtare është përgjegjëse për koston qe ka shkaktuar.

SHËNIME (VAZHDIM)
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2022

10 DEPOZITAT ME AFAT

	2022 EUR'000	2021 EUR'000
Depozitat me afat në bankat lokale	-	12,000
Llogaritë e bllokuara në banka	4,800	4,800
Interesi i përllogaritur	-	264
GJITHSEJ DEPOZITAT ME AFAT	**4,800**	**17,064**

Më 31 dhjetor 2021 depozitat me afat përbëhen nga depozitat afatshkurtra në bankat lokale me maturim deri në dymbëdhjetë muaj.
Më 31 Dhjetor 2022 dhe 2021, depozitat në vlerë prej 4,800 mijë euro janë vendosur si kolateral për huamarrjen në KFW (Shënimi 15).

11 PARAJA DHE EKUIVALENTËT E PARASË

	2022 EUR'000	2021 EUR'000
Paraja në bankë	67,273	35,448
Paraja në arkë	-	2
TOTALI I PARASË DHE EKUIVALENTËVE TË PARASË	**67,273**	**35,450**

12 KAPITALI AKSIONAR

	2022		2021	
	Shuma në EUR'000	% e interest të ekuitetit	Shuma në EUR'000	% e interest të ekuitetit
Kuvendi i Kosovës	25	100%	25	100%
TOTALI I KAPITALIT AKSIONAR	**25**	**100%**	**25**	**100%**

Kapitali aksionar përbëhet nga 25 mijë aksione të zakonshme me një vlerë nominale prej 1 EUR secili. Pronar i KOSTT Sh.A është Kuvendi i Republikës së Kosovës, që zotëron 100% të kapitalit të zakonshëm të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2022 (31 Dhjetor 2021: 100%)

Dividenda:

Me 27 Shtator 2021 Kompania ka deklaruar dhe paguar dividend në shumë prej 20,000 mijë EUR, bazuar ne vendimin e Qeverisë së Kosovës numër 13/31 të dates 25 Gusht 2021.Për shkak të vështirësive financiare të kompanisë,Qeveria e Kosovës me 23 Dhjetor 2021 ka revokuar vendimin numër 13/31 dhe ka kthyer prapa tek Kompania duke anuluar pagesën e dividentës.

13 REZERVA E TRANSFERIT

Rezerva e transferit, konsiston në rritjen e kapitalit aksionar në vlerë prej EUR 53,367 mijë EUR që ishte një kontribut jo-monetar përmes transferimit të aseteve nga KEK SH.A. tek Kompania në datën e inkorporimit të saj sipas marrëveshjes ndërmjet Kompanisë dhe KEK SH.A. Asetet e transferuara tek kompania në datën e inkorporimit të saj janë paraqitur më poshtë.

	EUR '000
Prona, impiantet dhe pajisjet	52,539
Inventari	837
GJITHSEJ	**53,376**

Gjatë vitit 2022 kompania i shtoi Rezervës së Transferit, objekte dhe pajisje rezervë shumën prej 9 mijë euro të identifikuar gjatë procesit të numërimit fizik të inventarit

SHËNIME (VAZHDIM)
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2022

14 GRANTET E SHTYRA

	2022 EUR '000	2021 EUR '000
Granti në lidhje me pronat, impiantet dhe pajisjet	41,107	45,287
Garant lidhur me shpenzimet e humbjeve të energjisë	-	2,327
Granti në lidhje me inventarin	1,927	1,969
GJITHSEJ GRANTET E SHTYERA	**43,034**	**49,583**

Grantet lidhen me fondet ose pasuritë e marra nga Qeveria e Republikës së Kosovës për të siguruar mbështetje financiare për aktivitetet operative dhe projektet kapitale të Kompanisë, të cilat janë në zhvillim e sipër, projektet e ardhshme kapitale dhe për mbulimin e humbjeve të energjisë në zonën Veriore të Republikës së Kosovës.

Lëvizjet gjatë vitit

Tabela vijuese përmbledh lëvizjet në grantin e shtyrë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor:

	2022 EUR '000	2021 EUR '000
Më 1 Janar	**49,583**	63,975
Grantet e pranuara	57,500	-
Minus:		
Të ardhurat e shtyra në P&L (shih tabelën më poshtë)	(64,049)	(14,392)
Më 31 Dhjetor	**43,034**	**49,583**

Më poshtë është analiza e grantit të njohur permes pasyrës së të ardhurave dhe llogaritet si e ardhur për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

	2022 EUR '000	2021 EUR '000
Zhvlerësimi i Pronës, Impianteve dhe pajisjeve (Shënimi 4)	6,507	6,657
Shpenzimet në lidhje me humbjet e energjisë në Komunat Veriore (21)	57,500	7,673
Inventari (Shënimi 8)	42	62
	64,049	**14,392**

15 HUATË

	2022 EUR'000	2021 EUR'000
Huatë KFW (shuma 17,000 mijë EUR maturimi 2024)	3,000	5,000
Huatë KFW (shuma 23,500 mijë EUR maturimi 2047)	12,878	14,495
Huatë EBRD (shuma 30,000 mijë EUR maturimi 2029)	16,721	19,118
Huatë nga Qeveria e Kosovës	26,441	-
	59,040	**38,613**
Pjesa qarkulluese	32,457	6,016
Pjesa jo-qarkulluese	26,583	32,597
GJITHSEJ HUATË	**59,040**	**38,613**

RAKORDIMI I BORXHIT NETO	2022 EUR'000	2021 EUR'000
Paraja dhe ekuivalentet e parasë dhe depozitat	72,073	52,514
Huamarrjet e pagueshme brenda një viti	(26,583)	(6,016)
Huamarrjet e pagueshme pas një viti	(32,457)	(32,597)
BORXHI NETO	**13,033**	**13,901**

Një marrëveshje kredie dhe financimi e datës 26 Shkurt 2022 midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Kosovës dhe Kompanisë. Kompania e ka marrë këtë hua për qëllime ekskluzive për mbulimin e detyrimeve financiare në lidhje me devijimet e shkaktuara në sistemin e interkonjeksionit të Evropës ENTSO-E. Pagesa e kësaj kredie do të bëhet me një pagesë të vetme brenda 12 muajve, por jo më vonë se përvjetori i parë i lëshimit të kredisë.

Një marrëveshje kredie dhe financimi e datës 28 dhjetor 2009 midis KfW dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Kosovës dhe Kompanisë. Projekti parashikon ndërtimin e Linjës së Transmisionit 400kV Shqipëri-Kosovë (Tiranë-Prishtinë). Shuma totale e kredisë dhe marrëveshjes së financimit është 33 500 mijë EUR e përbërë nga 16 500 mijë EUR kontribut financiar dhe kredi deri në 17 000 mijë EUR. Kontributi financiar nuk është i pagueshëm Kredia filloi të tërhiqej në 2015.

Një marrëveshje kredie dhe financimi e datës 23 shtator 2013 midis KfW dhe Ministrisë së Fiinancave dhe Ekonomisë së Republikës së Kosovës dhe Kompanisë. Projekti parashikon përmirësimin e rrjetit të transmetimit - Faza IV dhe V. Shuma totale e kredisë dhe marrëveshjes së financimit është 30 850 mijë EUR që përbëhet nga 3,000 mijë EUR kontribut financiar, kredi deri në 20 500 mijë EUR dhe 7 350 mijë EUR të financuara nga Bashkimi Evropian. Kontributi financiar nuk është i pagueshëm. Kredia filloi të tërhiqej në 2015

Një marrëveshje kredie e datës 15 tetor 2014 u nënshkrua midis Kompanisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Ky projekt do të implementohet brenda 4 viteve nga data e kontratës. Projekti parashikon përmirësimin e rrjetit ekzistues të transmetimit të energjisë së Kompanisë. Projekti është pjesë e planit katër vjeçar të investimeve kapitale të miratuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës (ZRRE) dhe do të përfshijë ndërtimin, rehabilitimin dhe vënien në punë të nënstacioneve, transformatorëve dhe linjave të transmetimit të energjisë elektrike të zgjedhura. Kostoja totale e vlerësuar e projektit është afërsisht 36 500 mijë EUR. Burimet e parashikuara të financimit të projektit janë si më poshtë: 4,500 mijë nga fondet e Kompanisë, 2,000 mijë EUR nga fondet e Donatorëve, Borxhi i Vjeter (BERZH) 30,000 mijë EUR.

16 DETYRIMET TREGTARE DHE TË TJERA

	2022 EUR'000	2021 EUR'000
Të pagueshmet tregtare:		
Kreditorët/ furnitorët e jashtëm	2,237	4,183
Kreditorët/ furnitorët vendor	34,449	23,017
	36,686	**27,200**
Të pagueshmet tjera afatshkurtë		
Detyrimet për jobalancat	41,426	51,826
Provizionet për detyrimet	5,531	5,280
TVSH e pagueshme	868	2,895
Pagat neto të pagueshme	324	-
Tatimi në paga dhe kontributet pensionale	107	71
Llogari të pagueshme tjera	414	153
	48,670	**60,225**
GJITHSEJ DETYRIME TREGTARE DHE TË TJERA	**85,356**	**87,425**

*Sipas Ligjit për energji elektrike dhe licencave, Kostt SH.A përveç tjerash është përgjegjëse edhe për balancimin e sistemit te energjisë elektrike. Ne nenin 16 te Ligjit për energji elektrike ne paragrafin 1.19 te këtij neni Operatori I Sistemit është përgjegjës për " balancimin e sistemit te energjisë elektrike ne harmoni me Kodin e rrjetit dhe Rregullat e tregut". Meqenëse energjia elektrike si produkt i cili liferohet ne kohe reale çdo here lajmërohet diference ne mes sasisë se kontraktuar dhe sasisë se prodhuar gjegjësisht te konsumuar. Diferenca ne mes energjisë se kontraktuar për liferim dhe energjisë se liferuar te matur e një nga një pale tregtare quhet jo balancë e palës dhe pala tregtare është përgjegjëse për koston qe ka shkaktuar.

Gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2022 Kompania ka njohur provizione në vlerë prej 5,531mijë EUR (31 dhjetor 2021:5,280 mijë EUR), nga të cilat 1,316 mijë EUR kanë të bëjnë me procedurat ligjore të filluara kundër kompanisë (Shënimi 32 Zotimet dhe kontigjencat) dhe 4,215 mijë EUR kanë të bëjnë me provizionet për detyrimet tregtare që dalin nga zgjidhjet e diskutueshme me dy furnitorë.

Lëvizjet në detyrimet e provizioneve janë si më poshtë

	2022 EUR'000	2021 EUR'000
Shuma e mbartur në fillim të vitit	5,280	4,828
Provizionet shtesë të njohura për Pretendimet Ligjore (Shënimi 22)	251	452
Shuma e mbartur në fund të vitit	**5,531**	**5,280**

17 TË ARDHURAT

	2022 EUR'000	2021 EUR'000
Të ardhurat nga transmisioni i energjisë	12,448	16,624
Të ardhurat nga operatori i sistemit	21,978	13,481
Të ardhurat nga operatori i tregut	294	328
GJITHSEJ TË ARDHURAT	**34,720**	**30,433**

SHËNIME (VAZHDIM)
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2022

18 TË ARDHURAT TJERA OPERATIVE

	2022 EUR'000	2021 EUR'000
Të ardhurat nga alokimi e kapaciteteve	9,231	4,575
Të ardhurat nga mbulimi i humbjeve (ERO Vendimi)	6,057	2,228
Të ardhurat e tjera	365	504
Të ardhurat nga energjia tranzit	501	155
Të ardhurat nga jobalacat e brendëshme	35	66
GJITHSEJ TË ARDHURAT TJERA	**16,189**	**7,528**

19 TË ARDHURAT/SHPENZIMET NGA BURIMET E RIPËRTRITSHME TË ENERGJISË

	2022 EUR'000	2021 EUR'000
Të ardhurat		
Të ardhurat nga Burimet e ripërtrishme të energjisë	43,439	29,662
	43,439	**29,662**
Shpenzimet		
Minus Shpenzimet për Burimet e ripërtrishme të energjisë	(42,203)	(23,129)
	(42,203)	**(23,129)**
Gjithsej të ardhurat, neto	**1,236**	**6,533**

Të ardhurat nga Burimet e Ripërtrishme të Energjisë janë realizuar bazuar në rregullën nr. 10/2017 nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës ('ZRRE)

20 TË ARDHURAT TJERA NGA GRANTET

	2022 EUR'000	2021 EUR'000
Amortizimi i granteve të shtyra të lidhura me PIP	6,549	6,719
Amortizimi i granteve të shtyra në lidhje me paratë e paguara	57,500	7,673
GJITHSEJ TË ARDHURAT TJERA	**64,049**	**14,392**

21 HUMBJA E ENERGJISË

	2022 EUR'000	2021 EUR '000
Humbja në transmetimin e energjisë	14,889	10,857
Humbja e energjisë në komunat e veriut	63,178	41,806
GJITHSEJ HUMBJA E ENERGJISE	**78,067**	**52,663**

Gjatë vitit 2022, Kompania njohu humbje në transmetimin e energjisë në shumën prej 14,889 mijë EUR (2021: 10,857 mijë EUR). Humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit paraqiten si një ndryshim midis energjisë elektrike të matur në hyrjen e rrjetit të transmisionit dhe energjisë së matur në daljen e rrjetit të transmisionit

Po ashtu, gjatë vitit 2022 kompania ka njohur shpenzime të humbjeve të energjisë për komunat e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Leposaviçit dhe Zubimpotok në vlerë prej 63,178 mijë euro (2021: EUR 41,806 mijë euro). Këto shpenzime mbulohen kryesisht nga grantet qeveritare në shumën prej 57,500 mijë euro dhe një pjesë tjetër mbulohen nga Kompania. (shih shënimin 14)

22 SHPENZIMET TJERA OPERATIVE

	2022 EUR'000	2021 EUR'000
Kostot e shërbimeve ndihmëse	9,887	7,107
Shpenzimet për jobalancat	571	599
Pagesa e gjobës dhe interesit	483	25
Shpenzimet e tjera	416	494
Shpenzimet për energji elektrike dhe karburant	305	373
Shpenzimet për provizionimet e rasteve qyqësore	251	452
Shpenzimet e energjisë në tranzit	181	428
Shpenzimet e rojeve të sigurisë	162	180
Materialet e zyrës dhe shpenzimet e inventarit të vegjël	57	99
Shpenzimet e shërbimeve komunale	40	38
Shpenzimet e udhëtimeve zyrtare	35	18
Tatimi në pronë dhe taksa të tjera	34	56
Shpenzimet e marketingut dhe përfaqësimit	27	80
Shpenzimet mjekësore	20	12
Sigurimi i automjeteve	15	17
Këshillim dhe shërbime të tjera	15	6
TOTAL OTHER OPERATING EXPENSES	**12,499**	**9,984**

23 SHPENZIMET E PERSONELIT

	2022 EUR'000	2021 EUR'000
Pagat bruto te personelit	4,737	4,698
Kontributet pensionale	500	496
Pagat për Bordin e Drejtorëve	104	80
Pagat për punëtorët e kontraktuar	4	13
GJITHSEJ SHPENZIMET E PERSONELIT	**5,345**	**5,287**

24 RIPARIMET DHE MIRËMBAJTJET

	2022 EUR '000	2021 EUR '000
Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimeve	606	827
GJITHSEJ RIPARIMET DHE MIRËMBAJTJET	**606**	**827**

25 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET FINANCIARE

	2022 EUR'000	2021 EUR'000
Të hyrat		
Të hyrat nga interesi	1,845	924
	1,845	**924**
Shpenzimet		
Shpenzimet e interesit	(1,456)	(1,370)
TË HYRAT FINANCIARE /(SHPEZNIMET), NETO	**389**	**(446)**

26 SHPENZIMET E TATIMIT NË FITIM

Sipas Ligjit mbi tatimin ne te ardhurat e Korporatave No 06/L -105 që është efektiv nga 5 Gusht 2019, Kompania është e detyruar që të paguaj tatimin mbi të ardhurat në një normë prej 10% mbi fitimin e tatueshëm, e llogaritur në Deklaratën vjetore të Tatimit mbi të Ardhurat. Ngarkesa e vitit mund të harmonizohet më fitim në pasqyren e të ardhurave gjithëpërfshirëse si në vijim:

	2022 EUR'000	2021 EUR'000
Fitimi(Humbja) para tatimit	1,265	(26,098)
Të ardhurat e përfshira për qëllime tatimore		
Rregullimet për dividenden e anuluar	-	20,000
Të ardhurat tjera të pa-zbritshme	-	73
	-	**20,073**
Shpenzimet e pa zbritshme për qëllime tatimore		
Rregullimet për zhvlerësim	(4,711)	(5,492)
Shpenzimet e pa-zbritshme	4,033	509
	(678)	**(4,983)**
Humbjet e bartura	(11,008)	-
Fitimi I Tatueshëm	**(10,421)**	**(11,008)**
Shpenzimet e tatimit në fitim për vitin	**-**	**-**

Tatimet e shtyra që rrjedhin nga diferencat e përkohshme përmblidhen si më poshtë:

	Shuma bartese	Baza për tatim	Diferenca e përkohshme	Norme tatimit	Detyrimi i tatimit të shtyrë
Pasuritë Neto më 31 Dhjetor 2021	139,615	78,932	60,683	10%	6,068
Pasuritë Neto më 31 Dhjetor 2022	124,805	59,417	65,388	10%	6,539

SHËNIME (VAZHDIM)
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2022

Lëvizja e diferencave të përkohshme gjatë vitit 2022 dhe 2021:

	Detyrimi tatimor i shtyrë
Më 1 Janar 2021	**5,519**
Tatimi mbi fitim i njohur gjatë vitit 2021	549
Më 31 Dhjetor 2021	**6,068**
Tatimi mbi fitim i njohur gjatë vitit 2022	471
Më 31 Dhjetor 2022	**6,539**

	2022 EUR'000	2021 EUR'000
Shpenzimi aktual i tatimit në fitim	-	-
Shpenzimi i tatimit të shtyrë	471	549
GJITHSEJ	**471**	**549**

27 INSTRUMENTET FINANCIARE NË BAZË TË KATEGORIVE

Shuma bartëse e pasurive dhe detyrimeve të Kompanisë të njohura në datën e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese nën rishikimin mund të kategorizohet si në vijim:

	2022 EUR'000	2021 EUR'000
PASURITË SIPAS PASQYRËS SË POZICIONIT FINANCIAR		
Në kosto të amortizuar		
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	82,916	75,381
Depozitat me afat	4,800	17,064
Paraja dhe ekuivalentët e saj	67,273	35,450
	154,989	**127,895**

DETYRIMET SIPAS PASQYRËS SË POZICIONIT FINANCIAR	2022 EUR'000	2021 EUR'000
Në kosto të amortizuar		
Huatë	59,040	38,613
Llogaritë e pagueshme tregtare	78,112	79,026
	137,152	**117,639**

28 MATJA E VLERËS SË DREJTË

Instrumentet financiare të njohura me vlerën e drejtë

Pasuritë financiare të matura me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar janë në përputhshmëri me hierarkinë e vlerës së drejtë e cila i grupon pasuritë dhe detyrimet në tre nivele bazuar në rëndësinë e të dhënave hyrëse të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejtë të pasurive financiare. Hierarkia e vlerës së drejtë është si në vijim:

- Niveli 1: Çmimet e kuotuara (jo të rregulluara) në tregjet aktive për pasuri dhe detyrime identike që njësia ekonomike mund të përdorë në datën e matjes;
- Niveli 2: Të dhëna të tjera përveç çmimeve të kuotuara, të përfshira në Nivelin 1 të cilat janë të vëzhgueshme për pasurinë ose detyrimin, qoftë në mënyrë direkte ose indirekte dhe
- Niveli 3: Të dhënat për pasuri ose detyrime që nuk janë të bazuara në të dhëna të vëzhgueshme tregu (të dhëna të pavëzhgueshme).

Më 31 dhjetor 2022 dhe 2021, Kompania nuk ka pasuri financiare të matura me vlerë të drejtë.

Instrumentet financiare që nuk janë paraqitur me vlerë të drejtë

Tabela në vijim përmbledh shumat bartëse dhe vlerat e drejta për ato pasuri dhe detyrime financiare që nuk janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën e tyre të drejtë.

	Vlera e bartur		Vlera e drejtë	
	2022 EUR '000	2021 EUR '000	2022 EUR '000	2021 EUR '000
Pasuritë				
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	67,273	35,450	67,273	35,450
Depozitat me afat	4,800	17,064	4,800	17,064
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	82,916	75,381	82,916	75,381
GJITHSEJ PASURI FINANCIARE	**154,989**	**127,895**	**154,989**	**127,895**
Detyrimet				
Detyrimet tregtare dhe të tjera	78,112	87,425	78,112	87,425
Huatë që bartin interes	59,040	38,613	59,040	38,613
GJITHSEJ DETYRIME FINANCIARE	**137,152**	**126,038**	**137,152**	**126,038**

Depozitat me afat dhe të arkëtueshmet

Depozitat me afat dhe të arkëtueshmet mbahen me kosto të amortizimit, minus provizionet për zhvlerësim. Për shkak të maturitetit të shkurtë, vlera e tyre e drejtë i përgjigjet vlerës së tyre bartëse.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Vlera e drejtë e pasurive monetare që përfshin paranë dhe ekuivalentet e parasë konsiderohet të jetë e përafërt me vlerat e tyre bartëse sipas definicionit dhe për shkak të maturitetit të shkurtë prej më pas se 3 muaj.

Të pagueshmet tregtare dhe huatë

Vlera bartëse e të pagueshmëve tregtare dhe të tjera i afrohet vlerës së tyre të drejtë për shkak të maturitetit të tyre afat shkurtër.

29 INFORMACIONE MBI RREZIQET FINANCIARE

Kompania i ekspozohet risqeve të ndryshme financiare në lidhje me instrumentet financiare. Pasuritë dhe detyrimet financiare të Kompanisë sipas kategorisë janë të përmbledhura në Shënimin 26. Llojet kryesore të risqeve janë risku i tregut, risku kreditor dhe risku i likuiditetit.

Menaxhimi i riskut të Kompanisë është i koordinuar nga menaxhmenti, në bashkëpunim të ngushtë me bordin e drejtorëve, dhe fokusohet që në mënyrë aktive të siguroj rrjedhat e parasë afatshkurtra dhe afatmesme të Kompanisë duke minimizuar ekspozimin e tyre ndaj tregjeve financiare të paqëndrueshme. Investimet financiare afatgjata janë të menaxhuara për të gjeneruar kthime të qëndrueshme. Investimet afatgjata financiare menaxhohen për të gjeneruar kthime të qëndrueshme. Kompania nuk angazhohet në tregtimin e pasurive financiare për qëllime spekulative dhe as nuk shkruan opsione. Risqet më të rëndësishme financiare nga të cilat Kompania është e ekspozuar janë përshkruar më poshtë.

a) Risku kreditor

Risku i kredisë menaxhohet në baza grupore. Nëse klientët me shumicë vlerësohen në mënyrë të pavarur, këto vlerësime përdoren. Përndryshe, nëse nuk ka vlerësim të pavarur, kontrolli i riskut vlerëson cilësinë e kredisë së klientit, duke marrë parasysh pozicionin e tij financiar, përvojën e kaluar dhe faktorët e tjerë. Kufijtë individual të riskut përcaktohen bazuar në vlerësimet e brendshme ose të jashtme, në përputhje me kufijtë e vendosur nga bordi. Pajtueshmëria me kufijtë e kredisë nga klientët me shumicë monitorohet rregullisht nga menaxhimi i linjës. Nuk ka garanci ndaj kësaj të arkëtueshme, por menaxhmenti monitoron nga afër gjendjen e të arkëtueshmeve në baza mujore dhe është në kontakt të rregullt me këtë klient për të zbutur rrezikun

Ekspozimi maksimal i Kompanisë ndaj riskut të kredisë përfaqësohet nga vlera kontabël e secilës pasuri financiare në pasqyrën e pozicionit financiar.

	2022 EUR '000	2021 EUR '000
Klasat e pasurive financiare - shumat bartëse		
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	82,916	75,381
Depozitat me afat	4,800	17,064
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	67,273	35,450
EKSPOZIMI MAKSIMAL NDAJ RREZIKUT KREDITOR	**154,989**	**127,895**

Kompania nuk mban kolateral për ndonjë të arkëtueshme të saj. Të gjitha llogaritë e arkëtueshme për të cilat ekziston evidencë objektive e zhvlerësimit janë zhvlerësuar në mënyrë të duhur.

Të arkëtueshmet tregtare

Kompania ka krijuar politika për të siguruar që shitjet e shërbimeve u bëhen klientëve me një histori krediti të përshtatshme. Kompania ka politika që kufizojnë sasinë e ekspozimit të kredisë ndaj çdo pale të kundërt.

Menaxhmenti i Kompanisë beson se shumat e vonuara por jo të zhvlerësuara janë të arkëtueshme, bazuar në sjelljen historike të vjetërsisë së pagesës dhe riskun e kredisë së klientit.

Vjetërsia e të arkëtueshmeve është si më poshtë::

	2022 EUR'000	2021 EUR'000
0- 30 ditë	21,077	7,726
31-90 ditë	8,375	19,043
Mbi 90 ditë	10704	-
	40,156	26,769
Minus: Provizonet për zhvlerësim	(1,331)	-
	38,825	**26,769**

SHËNIME (VAZHDIM)
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2022

Llogarit e Arkëtueshme nga jo-balancat

Sipas Ligjit për energjinë elektrike dhe licencat, KOSST sh.a përveç të gjithave është përgjegjëse edhe për balancimin e sistemit të energjisë elektrike. Në nenin 16 të Ligjit për energjinë elektrike në nenin 1.19 të këtij neni, Operatori i Sistemit është përgjegjës për: "balancimin e sistemit të strukturuar të energjisë elektrike në përputhje me Kodin e Rregullatorëve të Rrjetit të Transmetimit dhe Tregut". Edhe pse energjia elektrike si produkt i cili shpërndahet në kohë reale gjithmonë shpallet dallimi në mes të sasisë së kontraktuar dhe sasisë së prodhuar përkatësisht të konsumuar. Diferenca midis energjisë së kontraktuar për shpërndarje dhe energjisë së matur të dorëzuar të njërës prej palëve tregtare quhet çekuilibër i jobalancimit të palës dhe pala tregtare është përgjegjëse për koston që ka shkaktuar. Kompania ka politika që kufizojnë shumën e ekspozimit të kredisë ndaj çdo pale.
Më 23 mars 2023, Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka vendosur në favor të Kompanisë dhe ka këshilluar KEDS sh.a dhe KESCO sh.a që të shlyejnë bilancet e kontestuara të të arkëtueshmeve tregtare nga jobalancat e kontestuara nga KESCO sh. a dhe KEDS sh.a përkatësisht 11,445 mijë euro dhe 3,738 mijë euro.

	2022 EUR'000	2021 EUR'000
0- 30 ditë	17,986	48,612
31-90 ditë	7,955	-
Mbi 90 ditë	19,365	-
	45,306	**48,612**
Minus: Provizonet për zhvlerësim	(1,681)	-
	43,625	**48,612**

b) Risku i likuiditetit

Menaxhimi i kujdesshëm i riskut të likuiditetit nënkupton mbajtjen e mjeteve monetare të mjaftueshme dhe të letrave me vlerë të tregtueshme, si dhe disponueshmërinë e fondeve nëpërmjet lehtësive adekuate të kredisë dhe aftësinë për të mbledhur shumat e duhura nga klientët në kohën e duhur, brenda afateve të përcaktuara. Për shkak të natyrës dinamike të Kompanisë, menaxhmenti synon të mbajë fonde fleksibile duke mbajtur linjat e kreditit të zotuara në dispozicion. Tabelat në vijim paraqesin maturitetet e kontraktuara të mbetura të detyrimeve financiare të Kompanisë. Tabelat janë të përgatitura në baza të rrjedhës së parasë të pa zbritur të detyrimeve financiare.

	Afatshkurtë		Afatgjatë		
31 Dhjetor 2022	Brenda 1 viti EUR '000	1 deri 2 vite EUR '000	2 deri 5 vite EUR '000	Mbi 5 vjet EUR '000	Gjithsej EUR '000
Huatë	32,457	5,278	11,291	10,014	59,040
Llogaritë e pagueshme tregtare	85,356	-	-	-	85,356
	117,813	**5,278**	**11,291**	**10,014**	**144,396**

	Afatshkurtë		Afatgjatë		
31 Dhjetor 2021	Brenda 1 viti EUR '000	1 deri 2 vite EUR '000	2 deri 5 vite EUR '000	Mbi 5 vjet EUR '000	Gjithsej EUR '000
Huatë	6,016	6,147	11,785	14,665	38,613
Llogaritë e pagueshme tregtare	79,026	-	-	-	79,026
	85,042	**6,147**	**11,785**	**14,665**	**117,639**

c) Risku i tregut

Risku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, të tilla si kurset e këmbimit të huaj dhe normat e interesit do të ndikojnë në të ardhurat e Kompanisë ose vlerën e zotërimeve të saj të instrumenteve financiare. Objektivi i menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimin ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, përderisa optimizon kthimin.

d) Risku i normës së interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga rreziku që vlera e një instrumenti financiar do të luhatet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe risku që maturitetet e pasurive që bartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që bartin interes të përdorura për të financuar ato pasuri (risku i riçmimit). Kohëzgjatja e kohës për të cilën norma e interesit është e fiksuar në një instrument financiar në këtë mënyrë tregon se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit. Për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021, Kompania nuk është e ekspozuar ndjeshëm ndaj riskut të normës së interesit.

	2022 EUR '000	2021 EUR '000
Pasuritë financiare		
Që nuk bartin interes		
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	82,916	75,381
Paraja ne arkë	-	2
Me normë të interesit të përcaktuar		
Balancat bankare	67,273	35,448
Depozitat me afat	4,800	17,064
	154,989	**127,895**
Detyrimet financiare		
Që nuk bartin interes		
Detyrimet e tregtueshme dhe të tjera	85,356	87,425
Me normë fikse interesi		
Huatë që bartin interes	59,040	38,613
	144,396	**126,038**

e) Risku i valutave të huaja

Kompania nuk është e ekspozuar ndaj riskut të kursit të këmbimit pasi që Kompania nuk ka transaksione në valutë të huaj.

30 MENAXHIMI I RISKUT KAPITAL

Objektivat e Kompanisë në menaxhimin e kapitalit janë që të mbrojë aftësinë për të vazhduar me vijimësinë në mënyrë që të ofrojnë kthime për aksionarët dhe përfitime për palët e tjera të interesit dhe të mbajë një strukturë optimale të kapitalit për të reduktuar koston e kapitalit.

Menaxhmenti rishikon strukturën e kapitalit në baza të vazhdueshme. Si pjesë e këtij auditimi, menaxhmenti konsideron koston e kapitalit dhe riskun e lidhur me secilën klasë të kapitalit.

Raporti i borxhit

Menaxhmenti rishikon strukturën e kapitalit në baza të vazhdueshme. Si pjesë e këtij rishikimi, menaxhmenti konsideron koston e kapitalit dhe rrezikun e lidhur me secilën klasë të kapitalit.

The gearing ratio at year end is as follows:

	2022 EUR'000	2021 EUR'000
Huatë	59,040	38,613
Gjithsej ekuiteti	100,626	99,832
	58.67%	**38.68%**

31 PALËT E LIDHURA

Një palë është e lidhur me një entitet nëse, drejtpërdrejt ose indirekt përmes një ose më shumë ndërmjetësve, pala kontrollon, kontrollohet ose është nën kontroll të përbashkët me njësinë ekonomike, pala ka një interes në njësinë ekonomike që i jep asaj një ndikim të rëndësishëm mbi njësia ekonomike, pala ka kontroll të përbashkët mbi njësinë ekonomike, pala është një bashkëpunëtore ose partia është një anëtar i personelit drejtues kryesor të njësisë ekonomike ose shoqërisë mëmë të saj.

Kompania ka transaksione të palëve të lidhura gjatë rrjedhës normale të aktiviteteve të biznesit. Tabela më poshtë paraqet vëllimin dhe bilancet nga transaksionet e palëve të lidhura që prej dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2022 dhe 2021.

31 Dhjetor 2022	Grantet e shtyra EUR '000	Të ardhurat nga njohja e granteve EUR '000	Shpenzimet EUR '000	Huate EUR '000
Qeveria e Kosovës dhe donatorë tjerë	43,034	64,049	-	26,441
Kompensimi i menaxhmentit kyç	-	-	148	-
Anëtarët e Bordit	-	-	104	-
	43,034	**64,049**	**252**	**26,441**

31 Dhjetor 2021	Grantet e shtyra EUR '000	Të ardhurat nga njohja e granteve EUR '000	Shpenzimet EUR '000	Huate EUR '000
Qeveria e Kosovës dhe donatorë tjerë	49,583	14,392	-	-
Kompensimi i menaxhmentit kyç	-	-	154	-
Anëtarët e Bordit	-	-	80	-
	49,583	**14,392**	**234**	**-**

32 ZOTIMET DHE KONTIGJENCAT

Çështjet ligjore

Kohë pas kohe dhe në rrjedhën normale të biznesit, pretendime kundër Kompanisë mund të pranohen. Mbi bazën e vlerësimeve të veta dhe të këshillave të brendshme dhe të jashtme profesionale, menaxhmenti është i mendimit se nuk do të ketë humbje materiale në lidhje me pretendimet që tejkalojnë provizionet që janë bërë në këto pasqyra financiare.

Më 31 Dhjetor 2022 Kompania ishte e angazhuar në procedurat ligjore të filluara kundër Kompanisë në shumën prej 9,412 mijë EUR. Gjatë vitit që përfundon më 31 Dhjetor 2022, kompania njohu provizion në vlerë prej 251 mijë EUR. Provizioni i njohur pasqyron vlerësimin më të mirë të Menaxhmentit për rezultatin më të mundshëm.

Marrëveshjet
Marrëveshjet aktuale të huasë ndërmjet kompanisë dhe huadhënësve kërkojnë që Kompania të mbajë marrëveshjet e saj financiare brenda kufijve të kërkuar të përcaktuar në marrëveshjet e huasë. Raporti aktual i llogaritur në bazë të të dhënave financiare është brenda kufirit të kontraktuar.

Zotimet
Më 31 dhjetor 2022 punët e kontraktuara me kompanitë janë në shumën prej 9,721 mijë EUR (31 dhjetor 2021: 8,363 mijë EUR).

Pasuritë e lëna peng
Asnjë nga pasuritë e Kompanisë nuk është lënë peng si siguri për huazimet.

33 NGJARJET PAS DATËS RAPORTUESE

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar që mund të kërkojë rregullim ose shpalosje në pasqyrat financiare

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
AUDIT | TAX | CONSULTING

RSM Kosovo Sh.p.k is a member of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.

The RSM network is administered by RSM International Limited, a company registered in England and Wales (company number 4040598) whose registered office is at 50 Cannon Street, London EC4N 6JJ.

The brand and trademark RSM and other intellectual property rights used by members of the network are owned by RSM International Association, an association governed by article 60 et seq of the Civil Code of Switzerland whose seat is in Zug.

©RSM International Association

www.rsmks.com

RSM